



# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

[www.qpz.gov.al](http://www.qpz.gov.al)

**Nr.154**

**24 nëntor**

**2010**

## P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.10 337 datë 21.10.2010	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.10 083, datë 23.2.2009 “Për miratimin e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe AVN AG, STATKRAFT AS dhe Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë” .....	8129
Ligj nr.10 338 datë 21.10.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat” .....	8135
Vendim i KM nr.855, datë 21.10.2010	Për një shtesë në vendimin nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat e pranimit në institucionet publike të arsimit të lartë, cikli i parë i studimeve me kohë të plotë, si dhe për tarifatat e shkollimit, për vitin akademik 2010-2011”, të ndryshuar.....	8148
Vendim i KM nr.856, datë 21.10.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Petrelë, të qarkut të Tiranës.....	8149
Vendim i KM nr.857, datë 21.10.2010	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Konispol, të qarkut të Vlorës.....	8150
Vendim i KM nr.859, datë 27.10.2010	Për një shtesë në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Drenovë, të qarkut të Korçës, miratuar me vendimin nr.742, datë 8.9.2010 të Këshillit të Ministrave.....	8151

Vendim i KM nr.860, datë 27.10.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë truall dhe objekte, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Porto Romano-Durrës, loti I”.	8151
Vendim i KM nr.863, datë 27.10.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.66, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave “Për riorganizimin e drejtorive arsimore rajonale dhe zyrave arsimore”.....	8155
Vendim i KM nr.867, datë 5.11.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare.....	8155
Vendim i KM nr.868, datë 27.10.2010	Për shpenzimet dhe koston ekonomike për zbatimin e procedurave për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitore që kanë përfituar nga fondi kundërparti dhe “Non Project Grand Aid”, të ardhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë e të ushqimit.....	8156
Vendim i KM nr.873, datë 3.11.2010	Për caktimin e datës së fillimit e të përfundimit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore, si dhe të afatit të publikimit të të dhënave statistikore.....	8156
Vendim i KM nr.874, datë 3.11.2010	Për trajnimin e personelit të regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore.....	8157
Vendim i KM nr.877, datë 3.11.2010	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i realizimit të rezervuarit grumbullues të ujërave të shiut, Korçë.....	8158
Vendim i KM nr.879, datë 3.11.2010	Për një shtesë në vendimin nr.138, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave “Për procedurën e trajtimit të armëve, teknikës dhe pajisjeve të forcave të armatosura, të hequra nga armatimi dhe përdorimi” .....	8159
Vendim i KM nr.880, datë 3.11.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të mjekimit në Greqi, të fëmijës Morel Pashallari.....	8160
Vendim i KM nr.881, datë 3.11.2010	Për caktimin e zonave të vendosjes së antenave të komunikimit dhe të atyre radio-televizive në parkun kombëtar “Mali i Dajtit”	8160
Vendim i KM nr.882, datë 5.11.2010	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2010, miratuar, përkatësisht, për Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, për pagesën e detyrimeve ndaj Komisionit European...	8162
Vendim i KM nr.883, datë 9.11.2010	Për një shtesë në vendimin nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”, të ndryshuar.....	8162
Udhëzim i KM nr.6, datë 21.10.2010	Për zbatimin e ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” .....	8163

**LIGJ**  
**Nr.10 337, datë 21.10.2010**

**PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 10 083, DATË 23.2.2009 “PËR  
MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT NDËRMJET MINISTRISË SË  
EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS, SI AUTORITET KONTRAKTUES, DHE  
AVN AG, STATKRAFT AS DHE DEVOLL HYDROPOWER, SHA, SI  
BASHKËKONCESIONARË PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN  
NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT  
TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL, NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI**  
**I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Në titull e kudo në ligj fjalët “AVN AG” zëvendësohen me fjalët “EVN AG”.

**Neni 2**

Miratohet shtesa e 1-rë e kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, si autoritet kontraktues, dhe EVN AG, Statkraft AS dhe Devoll Hydropower sh.a., si bashkëkoncesionarë për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji.

**Neni 3**

Miratohet ndreqja e mospërputhjeve ndërmjet përkthimit shqip të publikuar të kontratës së koncesionit dhe versionit anglisht të kësaj kontrate, të nënshkruar nga palët, si më poshtë:

1. Paragrafi, që vijon pas seksionit 1.1.3 të kontratës së koncesionit, të titulluar “Përkufizimet”, numërtohet 1.2.

2. Në fund të përkufizimit “Rrugët hyrëse”, në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, referenca në seksionin 7.2.6 bëhet 7.2.7.

3. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, shkronja “b”, përkufizimi “Ndryshim në ligj” para fjalëve “përveçse si pasojë e” shtohen fjalët “në dëm të koncesionarit”.

Pas ndreqjes fjalia lexohet: “Çdo autorizim dhënë koncesionarit dhe që kërkohet prej tij për të përmbushur detyrimet e veta sipas kontratës ose ndonjë kontrate tjetër të nevojshme për shfrytëzimin, mirëmbajtjen ose financimin e projektit dhe që më pas ndërpritet, anulohet, amendohet, ndryshohet ose zëvendësohet në vend të koncesionit, përveçse si pasojë e.”

4. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, në fund të përkufizimit të fjalisë “Përfundimi i punimeve sipas grafikut” referenca në seksionin 7.2.2 zëvendësohet me 7.2.3.

5. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, në përkufizimin “Pagesa e koncesionit”, referenca në seksionin 0 zëvendësohet me 4.1.

6. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, në përkufizimin “Data e përfundimit të ndërtimit sipas grafikut”, shkronja “q” zëvendësohet me fjalën “që”.

Pas ndreqjes fjalia lexohet: “Data e përfundimit të punimeve të ndërtimit sipas grafikut” është data që rezulton kur zbriten 72 muaj nga data e fillimit të punimeve të ndërtimit.”.

7. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, në përkufizimin “Vlera e dëmeve të likuidueshme”, shkronjat “c”, “d”, “e” dhe “f” rinumërtohen respektivisht “a”, “b”, “c” dhe “d”.

8. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, përkufizimi “Minimum Technical Requirements” hiqet.

9. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, përkufizimi “Sistemi i prokurimit” hiqet.

10. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, pas fjalëve “Gëzim i qetë” shtohet ky përkufizim:

““Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme” është Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme e Republikës së Shqipërisë.”.

11. Në seksionin 1 të kontratës së koncesionit, në përkufizimin “NBK minimale e nevojshme” shifra “1%” zëvendësohet me “10%”.

12. Në seksionin 2.2.1 të kontratës së koncesionit, në shkronjën “e” pas fjalëve “t’i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e sheshit dhe të drejtën për kalim dhe t’i transferojë Autoritetit pronësinë e hidrocentraleve” shtohen fjalët “përfshirë digën ekzistuese të Banjës”.

Pas ndreqjes paragrafi lexohet: “t’i kthejë sërish Autoritetit Kontraktues përdorimin e sheshit dhe të drejtën për kalim dhe t’i transferojë Autoritetit pronësinë e hidrocentraleve, përfshirë digën ekzistuese të Banjës, me mbarimin e afatit, si dhe, në çdo rast, t’i kryejë ato veprime, të cilat janë pazgjydhshëmrisht të lidhura me këto veprimtari (së bashku, “të drejtat koncesionare”).”.

13. Në seksionin 2.3, pas shkronjës “b”, shtohet shkronja “c” me këtë përmbajtje: “Në lidhje me dhënien e këtyre pjesëve të sheshit, të cilat aktualisht janë në pronësi të organeve të pushtetit vendor dhe që nuk mund shpronësohen, koncesionari do t’u paguajë pronarëve ose do t’i japë Autoritetit Kontraktues kompensimin e duhur dhe të arsyeshëm për vënien në dispozicion të këtyre pjesëve të sheshit koncesionarit.”.

14. Paragrafi i fundit i seksionit 2.4.4, nëndarja (ii) është si vijon: “Në lidhje me tunelet, vendin (shpellën) e centralit, digat, makineritë dhe/ose pajisjet e ndërtuara ose të instaluar në lidhje me projektin që tejkalon në çdo rast 0.1% (zero pikë një për qind) të kostos së investimit të këtyre tuneleve, vendit (shpellës) së centralit, makinerive dhe/ose pajisjeve, do të vendoset mbi koncesionarin në lidhje me projektin.”.

15. Në seksionin 2.6.4, pas fjalisë së fundit shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Për shmangien e dyshimeve, përgjegjësia e koncesionarit sipas këtij neni 2.6.4 nuk e tejkalon përgjegjësinë sipas ligjeve shqiptare.”.

16. Në seksionin 2.6.6, në fund të paragrafit të parë, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje: “Koncesionari merr përsipër të gjitha rreziqet e shkaktuara nga dëmtimi, shkatërrimi ose prishja e pajisjeve mbrojtëse bllokuese nga përfundimi i ndërtimit të tyre, me kusht që kjo të shkaktohet nga pakujdesia e koncesionarit.”.

17. Në seksionin 3.3 të kontratës së koncesionit shtohet nënparagrafi 3.3.3, me përmbajtje si vijon: “Nëse të dhënat shtetërore: (i) janë marrë nga koncesionari siç parashikohet në shtojcën J dhe brenda afatit të parashikuar në nenin e mësipërm 3.3.2, koncesionari duhet t’i dorëzojë autoritetit kontraktues sa më shpejt të jetë e mundur kërkesën e tij për lejet e zhvillimit të punimeve së bashku me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për këtë kërkesë, por jo më vonë së një muaj pas afatit të përcaktuar në nenin e mësipërm 3.3.2; (ii) nuk janë marrë nga koncesionari siç parashikohet në shtojcën J dhe brenda afatit të parashikuar në nenin e mësipërm 3.3.2, koncesionari duhet t’i dorëzojë Autoritetit Kontraktues sa më shpejt të jetë e mundur kërkesën e tij për lejet e zhvillimit të punimeve së bashku me të gjithë dokumentacionin e kërkuar për këtë kërkesë, por jo më vonë se 3 muaj pas afatit të përcaktuar në nenin e mësipërm 3.3.2”.

18. Nënparagrafi ekzistues 3.3.3, në seksionin 3.3 të kontratës së koncesionit, rinumërtohet 3.3.4; nënparagrafi 3.3.4 rinumërtohet 3.3.5; nënparagrafi 3.3.5 rinumërtohet 3.3.6, si dhe referenca në seksionin 3.3.6 përdorur në këtë nënparagraf zëvendësohet me referencën në seksionin 3.3.7, respektivisht; nënparagrafi 3.3.6 rinumërtohet 3.3.7.

19. Në fund të fjalisë së fundit të nënparagrafit 3.4.4 shtohet fjalia: “(në rastin e fundit ruajtja duhet të jetë në përputhje me ligjin shqiptar)”.

20. Në fjalinë e fundit të seksionit 4.1.1, shkronja “b”, të kontratës së koncesionit, referenca në seksionin 4.1 zëvendësohet me 4.1.1.

21. Seksioni 7.1 i kontratës së koncesionit bëhet: “projekti i detajuar do të përgatitet në përputhje me dispozitat e përcaktuara në pjesën A të shtojcës A, në mënyrë që çdo hidrocentral të jetë plotësisht në përputhje me kërkesat teknike minimale.”.

22. Në seksionin 7.2.3 të kontratës së koncesionit hiqen fjalitë vijuese: “Në qoftë se përfundimi paraprak i hidrocentraleve (jo hidrocentrali i Banjës) arrihet përpara afatit të grafikut, koncesionari, në bazë të nenit 7.2.3, për çdo ditë përfundimi para afatit do të përftojë kreditë e mëposhtme: Në qoftë se dëmet e likuidueshme janë paguar ose janë bërë të pagueshme sipas nenit 7.2.4, për shkak se koncesionari nuk ka arritur përfundimin e ndërtimit të hidrocentralit të Banjës brenda 36 muajve nga data e fillimit të punimeve ndërtimore, Autoriteti Kontraktues do të bëjë rimbursimin e menjëhershëm të shumave përkatëse të dëmeve të likuidueshme për ditët e kredituara sipas paragrafit të mësipërm.”

23. Në seksionin 7.2.4 të kontratës së koncesionit, krahas referencës në seksionin 10.2 shtohet referenca në seksionin 7.3.

24. Në fund të fjalisë së fundit të seksionit 7.2.6 nënndarja (i), shuma 10 500 euro bëhet 10 500 000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) euro, si dhe shtohet fjalia vijuese: “dhe koncesionari do të konfirmojë se i ka këto fonde sapo të kenë filluar proceset përkatëse të tenderit”.

Në seksionin 7.2.6, nënndarja (ii), fjalët “në shtojcën [ ]” zëvendësohen me fjalët “në shtojcën I”; në paragrafin e fundit të seksionit 7.2.6, nënndarja (iii), referenca në seksionin 7.2.5 zëvendësohet me referencën në seksionin 7.2.6. Pas ndreqjes fjalia lexohet si vijon: “i) shumën 10 500 000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) euro, sipas shtojcës I, të përgatitur nga koncesionari, për rrugët dhe urat e mbuluara me ujë, sipas inventarit dhe vlerave të listuara në të. Autoriteti Kontraktues mund ta marrë këtë kompensim për pjesën përkatëse kur ky autoritet të fillojë ndërtimin e infrastrukturës zëvendësuese në lidhje me secilin hidrocentral dhe koncesionari do të konfirmojë se i ka këto fonde sapo proceset përkatëse të tenderit të kenë filluar.”

25. Në seksionin 7.3.11, shkronja “c”, të kontratës së koncesionit, referenca në seksionin 11.1 “a” zëvendësohet me referencën në seksionin 11.2. “c”.

26. Në seksionin 7.3.14, shkronja “c”, nënndarja (iii) të kontratës së koncesionit, në vend të fjalëve “Hidrocentralin e Skënderbegas - Cekinit”, futen “Hidrocentralin e Banjës”; në 7.3.14 (f), referenca në seksionin 7.2.4 zëvendësohet me referencën në seksionin 7.2.5.

Versioni i botuar (në gjuhën shqipe) pas ndreqjes, lexohet si vijon: (“nga ku zbriten shumat e tërhequra deri në atë kohë për pretendimet lidhur me Hidrocentralin e Banjës”).

27. Në fund të seksionit 9.3 të kontratës së koncesionit shtohet fjalia, me këtë përmbajtje: “Nëse koncesionari vonon të rimbursojë Autoritetin Kontraktues në lidhje me shpenzimet sipas këtij neni 9.3, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë t'i tërheqë këto shuma nga garancia e kontratës pasi të ketë njoftuar me shkrim koncesionarin.”.

28. Në seksionin 10.2.3 të kontratës së koncesionit, pas fjalëve “pengesën, vështirësimin ose vonesën në përmbushjen e detyrimeve sipas kontratës nga pala e cenuar” shtohen fjalët: “dhe/ose ku pala e cenuar është koncesionari.”

Pas ndreqjes fjalia lexohet si vijon: “Nëse është rënë dakord ose është vendosur se ka ndodhur rasti i forcës madhore dhe ky rast ka sjellë si pasojë pengesën, vështirësimin ose vonesë në përmbushjen e detyrimeve sipas kontratës nga pala e cenuar dhe/ose ku pala e cenuar është koncesionari, në shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e projektit, atëherë pala e cenuar do të përjashtohet nga përmbushja sipas kontratës e detyrimeve që janë cenuar nga ky rast i forcës madhore për gjithë kohëzgjatjen e këtij rasti dhe do të ketë të drejtën e shtyrjes së ndonjë date përfundimi ose date të planifikuara për aq sa zgjat rasti i forcës madhore.”

29. Në fund të seksionit 11.9 të kontratës së koncesionit, pas fjalëve “Nenin 11.3 (Mospërmbushja nga Autoriteti Kontraktues),” futet nënndarja (i) dhe shtohen fjalët “ose nënndarja (ii) nëse zgjidhja ndodh pas datës së përfundimit faktik të punimeve, një shumë e llogaritur siç parashikohet në nënndarjen (i) më sipër me kusht që shuma e parashikuar në nënndarjet (i) (x) të zvogëlohet me 1.69% (një pikë gjashtëdhjetë e nëntë për qind) për çdo vit të plotë në të cilin ndodh zgjidhja pas datës së përfundimit faktik të punimeve”.

Pas ndreqjes paragrafi lexohet si vijon: “Në rast se koncesionari e zgjidh këtë kontratë pas fillimit të fazës së ndërtimit për ndonjë nga shkaqet e specifikuara në nenin 11.3 (Mospërmbushja

nga Autoriteti Kontraktues), nënndarja (i), Autoriteti Kontraktues do t'i paguajë koncesionarit, duke marrë në konsideratë transferimin sipas parimit “ashtu siç është ndërtuar”, të hidrocentraleve dhe të të gjitha të drejtave e aseteve lidhur me ta të Autoritetit Kontraktues në përputhje me këtë kontratë, një shumë e barabartë me (x) kosto faktike të investimeve, (y) vlerën aktuale neto duke përdorur EURIBOR-in 3-mujor plus 50 bps në kohën e zgjidhjes si norma zbritjeje të derdhjeve neto *cash* të parashikuara të projektit, ashtu siç është përcaktuar nga preventivi i arsyeshëm i ekspertit teknik dhe ekonomik për vitet që nga koha e zgjidhjes deri në 59-vjetorin e datës së përfundimit faktik të punimeve dhe (z) çdo kosto të bërë nga koncesionari në lidhje me ose si rezultat i zgjidhjes së kësaj kontrate, duke përfshirë koston e zgjidhjes përsa u përket punëmarrësve dhe kostove që u paguhen kontraktorëve ose nënndarja (ii), nëse zgjidhja ndodh pas datës së përfundimit faktik të punimeve, një shumë e llogaritur siç parashikohet në nënndarjen (i) më sipër me kusht që shuma e parashikuar në nënndarjet (i) dhe (x) të zvogëlohet me 1.69% (një pikë gjashtëdhjetë e nëntë për qind) për çdo vit të plotë në të cilin ndodh zgjidhja pas datës së përfundimit faktik të punimeve.”.

30. Në seksionin 11.10 të kontratës së koncesionit fjalët “(një presje gjashtëdhjetë e nëntë) për qind” zëvendësohen me fjalët “(një pikë gjashtëdhjetë e nëntë) për qind”.

31. Pas seksionit 11.11 të kontratës së koncesionit shtohet seksioni 11.12 me këtë përmbajtje: “Me zgjidhjen e kësaj kontrate, çdo e drejtë, titull apo interes, që i është dhënë koncesionarit në lidhje me sheshin, do t'i transferohet menjëherë Autoritetit Kontraktues, çdo leje për zhvillimin e punimeve apo autorizim do të konsiderohet si i pavlefshëm dhe koncesionari është i detyruar t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktues të gjithë dokumentacionin e projektit, studimet, raportet, etj. në lidhje me projektin. Çdo shume, që i duhet paguar Autoritetit Kontraktues sipas neneve 11.7, 11.8, 11.9 ose 11.10, do t'i zbriten të ardhurat e sigurimeve të marra apo që janë për t'u marrë nga koncesionari për shkak të zgjidhjes.”.

32. Seksioni ekzistues 11.12 i kontratës së koncesionit rinumërohet 11.13.

33. Në seksionin 12.1.2, nënndarja (i), të kontratës së koncesionit, referenca në seksionin 11.2 zëvendësohet me referencën në seksionin 11.3; në fjalinë e parë të seksionit 12.1.2, nënndarja (iii) e kontratës së koncesionit, pas fjalëve “në rast të zgjidhjes nga Autoriteti Kontraktues, si rezultat i mospërmbushjes nga koncesionari” shtohen fjalët “(shih nenin 11.2).”.

Pas ndreqjes paragrafi lexohet si vijon:

“i) në rast të zgjidhjes së kontratës si rezultat i mospërmbushjes nga Autoriteti Kontraktues (shih nenin 11.3), me përjashtim të për aq sa mospërmbushja nga Autoriteti Kontraktues të ketë shkaktuar dëme ose shkatërrimin e plotë a të pjesshëm të hidrocentralit;

ii) në rast të zgjidhjes nga Autoriteti Kontraktues si rezultat i mospërmbushjes nga koncesionari (shih nenin 11.2).”

34. Në seksionin 14.2.2 të kontratës së koncesionit, përpara referencës në seksionin 14.2.1 shtohen fjalët “10.3 dhe”.

35. Fjalja e fundit e shkronjës “a”, në shkronjën A (Kërkesat teknike minimale), në shtojcën A, që parashikon “Në rastet e shpronësimit të tokës sipas kësaj marrëveshjeje, koncesionari do të respektojë dhe do të ruajë të drejtat ekzistuese të palëve të treta për të marrë ujë për vaditje për aq sa këto të drejta janë autorizuar ligjërisht dhe faktikisht përdoren në datën e fillimit” hiqet.

36. Në shtojcën B, pas titullit “Procedura treguese e shpronësimit”, titulli “Procedura e shpronësimit” hiqet.

37. Në fillim të seksionit 5 të shtojcës C të kontratës së koncesionit, fjalja “Sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2009 “Për sektorin e energjisë”” zëvendësohet me fjalinë: “Sipas ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike””.

38. Në fjalinë e fundit të shtojcës E të kontratës së koncesionit, në paragrafin që fillon me fjalët “Shpenzimet e fazës II”, fjalja “për shmangien e çdo keqinterpretimi, rishlyerja e principalit për çdo hua të tillë nuk përbën një shpenzim” është përsëritur dhe zëvendësohet me fjalinë “të tilla si interesi mbi huat që i janë dhënë shoqërisë koncesionare dhe të gjitha pagesat e bëra në lidhje me këto hua dhe, si rrjedhojë, garancia e dhënë) nuk do të përbëjnë shpenzimet e fazës II.”

39. Në shtojcën G, pas fjalisë “Duhet të tregohen aftësitë e mëposhtme: nënndarjet (iv) dhe (v) rinumërohen, përkatësisht, (i) dhe (ii).

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6743, datë 28.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi.**

### **SHTESA 1**

**NË KONTRATËN E KONCESIONIT PËR PROJEKTIMIN, FINANCIMIN, NDËRTIMIN, MARRJEN NË PRONËSI, SHFRYTËZIMIN, MIRËMBAJTJEN DHE TRANSFERIMIN E PROJEKTIT TË HIDROCENTRALIT NË LUMIN DEVOLL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË NDËRMJET MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS (SI AUTORITETI KONTRAKTUES) DHE EVN AG, STATKRAFT AS DHE DEVOLL HYDROPOWER SHA (SI BASHKËKONCESIONARË)**

Shtesa 1 është lidhur ndërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës si Autoritet Kontraktues dhe “EVN AG”, “STATKRAFT AS” dhe “Devoll Hydropower” sh.a. si bashkëkoncesionarë (në vijim referuar si “Marrëveshja” ose “Shtesa 1”), \_\_\_\_\_ 2010.

Kjo shtesë (shtesa 1) në Kontratën e Koncesionit për projektimin, financimin, ndërtimin, marrjen në pronësi, shfrytëzimin, mirëmbajtjen dhe transferimin e projektit të hidrocentralit në lumin Devoll, në Republikën e Shqipërisë (Kontrata) lidhet sot, më \_\_\_\_\_ 2010, ndërmjet:

1. Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës së Republikës së Shqipërisë, Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, 1001 Tiranë, Shqipëri, që vepron në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.463, datë 18 korrik 2007, pjesa e parë e tij dhe referuar si “METE” ose “Autoriteti Kontraktues”, dhe

2. a) “EVN AG”, shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Austrisë, me seli në adresën: EVN Platz, 2344 Maria Enzersdorf, Austria dhe regjistruar në regjistrin e shoqërive të Gjykatës Tregtare të Wiener Neustadt me nr. regjistrimi 72 000h (EVN);

b) “STATKRAFT AS”, shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Norvegjisë, me seli në adresën: Lilleakerveien 6, 0283 Oslo, Norway, dhe regjistruar në regjistrin e shoqërive të Norvegjisë me numër regjistrimi 987 059 699 “STATKRAFT”; dhe

c) “Devoll hydropower” sh.a., shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Republikës së Shqipërisë, me seli në adresën: rr.“Papa Gjon Pali II”, ABA Business Center, zyra nr.1204, Tiranë, Shqipëri dhe regjistruar në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit të Shqipërisë “Shoqëria Koncesionare”, (secili referohet si “Bashkëkoncesionar” dhe së bashku “Koncesionari”.

Secilit prej tyre, si Autoritetit Kontraktues, ashtu edhe bashkëkoncesionarëve, do t’u referohet individualisht si “Pala” dhe bashkërisht “Palët”.

### **DEKLARATA HYRËSE**

Duke qenë se Kontrata e Koncesionit: (i) u nënshkrua prej Palëve më 19 dhjetor 2008; (ii) u ratifikua prej Kuvendit të Shqipërisë nëpërmjet ligjit nr.10 083, datë 23 shkurt 2009; dhe (iii) u publikua në Fletoren Zyrtare të Shqipërisë (Fletorja Zyrtare) nr.28, datë 17 mars 2009.

Sipas pikës (E) së Deklaratës Hyrëse të Kontratës së Koncesionit, vlefshmëria e Kontratës së Koncesionit ishte e kushtëzuar dhe Kontrata e Koncesionit do të hynte në fuqi të plotë dhe do të prodhonte efekte në datën më të vonë të sa më poshtë: (i) nënshkrimi i saj nga Palët; (ii) data e miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë; dhe (iii) 15 ditë pas datës së botimit në Fletoren Zyrtare të ligjit ratifikues të Kontratës së Koncesionit nga Kuvendi i Shqipërisë (Fletorja Zyrtare). Në mënyrë që Kontrata e Koncesionit të hynte në fuqi, kushtet (i) deri në (iii) duhet të plotësoheshin përpara fundit të marsit 2009 (data e hyrjes në fuqi), përveç kur Palët bien dakord ndryshe. Deri tani nuk provohet të ketë ndonjë marrëveshje të Palëve në lidhje me këtë fakt.

Përderisa dita e 15-të pas datës së publikimit në Fletoren Zyrtare, pra 17 mars 2009, ka qenë data 1 prill 2009, kjo do të thotë se kushti (iii) më lart nuk është përmbushur në kohë, Palët tani dëshirojnë të njohin dhe të pranojnë, në shprehje të vullnetit të tyre të lirë dhe të pavesuar,

nëpërmjet nënshkrimit të shtesës 1 (në përputhje me paragrafin e fundit të pikës (E) të Deklaratës Hyrëse të Kontratës së Koncesionit) që Kontrata e Koncesionit, pavarësisht publikimit të vonuar në Fletoren Zyrtare siç përmendet më lart, ka hyrë në fuqi dhe vazhdon të qëndrojë në fuqi të plotë, që nga data 1 prill 2009.

Si rrjedhojë, duke vlerësuar sa më sipër, Palët këtu bien dakord për sa vijon:

#### 1. INTERPRETIMI

1.1 Çdo term me germa të mëdha që nuk është përkufizuar në shtesën 1 ka kuptimin që i është dhënë atij termi në Kontratën e Koncesionit.

#### 2. VLEFSHMËRIA E KONTRATËS SË KONCESIONIT

2.1 Palët nëpërmjet kësaj njohin dhe pranojnë (në përputhje me paragrafin e fundit të pikës (E) të Deklaratës Hyrëse të Kontratës së Koncesionit) se Kontrata e Koncesionit me kushtet dhe afatet e parashikuara në versionin e nënshkruar, pavarësisht publikimit të vonuar në Fletoren Zyrtare, ka hyrë në fuqi, dhe vazhdon të qëndrojë në fuqi të plotë, që nga data 1 prill 2009.

#### 3. MIRATIMI PREJ KËSHILLIT TË MINISTRAVE DHE RATIFIKIMI PREJ KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

3.1 Palët nëpërmjet kësaj njohin se shtesa e I-rë do të hyjë plotësisht në fuqi dhe do të jetë e zbatueshme në të njëjtën mënyrë siç parashikohet në pikën (E) të Deklaratës Hyrëse të Kontratës së Koncesionit, d.m.th. në datën sa më vonë të sa më poshtë: (i) nënshkrimi i saj nga Palët; (ii) datën e miratimit të saj nga Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë; dhe (iii) 15 ditë pas datës së botimit të ratifikimit të shtesës së 1-rë nga Kuvendi i Shqipërisë në Fletoren Zyrtare.

3.2 Nëpërmjet ratifikimit të kësaj Marrëveshjeje, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë autorizon Autoritetin Kontraktues të veprojë dhe të jetë pjesë e kësaj Marrëveshjeje në emër të Republikës së Shqipërisë, e cila rrjedhimisht bëhet gjithashtu, pjesë në këtë Marrëveshje.

#### 4. HEQJA DORË NGA KONCESIONARI

Duke pasur parasysh që Kontrata e Koncesionit ka hyrë në fuqi të plotë prej datës 1 prill 2009, Koncesionari, nëpërmjet këtij neni, heq dorë nga e drejta për të ngritur padi kundrejt METE, dhe/ose Republikës së Shqipërisë, për ankesa që mund të kenë lindur ose mund të lindin nga mospublikimi i ligjit ratifikues të Kontratës së Koncesionit, brenda afatit të përcaktuar nën kushtin (iii) të pjesës hyrëse (E) të Kontratës së Koncesionit. Heqja dorë do të zbatohet edhe mbi të drejtën për të kërkuar çlirimin e garancisë së kontratës, për shkak të publikimit të vonuar të ligjit ratifikues të Kontratës së Koncesionit.

#### 5. TË NDRYSHME

5.1 Palët bien dakord që parashikimet e seksioneve 14.2, 14.4 deri 14.6, 14.8 dhe 14.10 deri 14.16 të Kontratës së Koncesionit do të zbatohen, *mutatis mutandis*, në shtesën 1. Më tej Palët bien dakord që dispozitat e arbitrazhit të përshkruara në seksionin 13.3.2 deri 13.3.4 do të zbatohen edhe për shtesën e 1-rë.

Shtesa 1 është nënshkruar nga përfaqësuesit e autorizuar rregullisht të Palëve, në datën, muajin dhe vitin e përmendur më lart.

MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË  
DHE ENERGJETIKËS E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Nga: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

EVN AG

Nga: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

STATKRAFT AS

Nga: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_



DEVOLL HYDROPOWER SHA

Nga: \_\_\_\_\_

Emri: \_\_\_\_\_

Funksioni: \_\_\_\_\_

**LIGJ**

**Nr.10 338, datë 21.10.2010**

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË  
DHE MBRETËRISË SË SPANJËS PËR SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE  
PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL, NË LIDHJE ME TATIMIN MBI TË  
ARDHURAT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI  
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

**VENDOSI:**

**Neni 1**

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal, në lidhje me tatimin mbi të ardhurat”.

**Neni 2**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6744, datë 28.10.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,  
Bamir Topi.**

**MARRËVESHJE**

**NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE MBRETËRISË SË SPANJËS PËR  
SHMANGIEN E TATIMIT TË DYFISHTË DHE PARANDALIMIN E EVAZIONIT FISKAL NË  
LIDHJE ME TATIMIN MBI TË ARDHURAT**

Republika e Shqipërisë dhe Mbretëria e Spanjës me dëshirën për të lidhur një Marrëveshje për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimin mbi të ardhurat, kanë rënë dakord si më poshtë:

**KAPITULLI I  
OBJEKTI I MARRËVESHJES**

**Neni 1**

**Personat e përfshirë**

Kjo Marrëveshje do të zbatohet për persona, të cilët janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktuese.

Neni 2  
**Tatimet e përfshira**

1. Kjo Marrëveshje zbatohet për tatimet mbi të ardhurat, të vëna në emër të një shteti kontraktues, nënndarjeve të tij politike apo të autoriteteve të tij lokale, pavarësisht nga mënyra në të cilën ato vilen.

2. Do të konsiderohen tatime mbi të ardhurat të gjitha tatimet e vëna mbi të ardhurat në tërësi ose elemente të të ardhurave, duke përfshirë tatimet mbi fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme ose të paluajtshme, tatimet mbi shumat e plota të pagave ose rrogave të paguara nga ndërmarrjet, si dhe tatimet mbi vlerësimin e kapitalit.

3. Tatimet ekzistuese për të cilat zbatohet Marrëveshja, në veçanti janë:

a) në Shqipëri:

i) tatimet mbi të ardhurat; dhe

ii) tatimi mbi aktivitetet e biznesit të vogël;

(këtu quhet “tatimi shqiptar”);

b) në Spanjë:

i) tatimet mbi të ardhurat e individëve;

ii) tatimet e korporatave;

iii) tatimet mbi të ardhurat e jorezidentëve; dhe

iv) tatimet lokale mbi të ardhurat;

(këtu quhen “tatimi spanjoll”).

4. Marrëveshja zbatohet gjithashtu për çdo tatim të njëjtë ose në thelb të ngjashëm që është vendosur pas datës së nënshkrimit të Marrëveshjes, si shtesë ose në vend të tatimeve ekzistuese. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese njoftojnë njëri-tjetrin në lidhje me çdo ndryshim thelbësor që është bërë në ligjet e tyre përkatëse mbi tatimet.

**KAPITULLI II  
PËRKUFIZIMET**

Neni 3  
**Përkufizime të përgjithshme**

1. Për qëllimet e kësaj Marrëveshje, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

a) Termi “Shqipëri” nënkupton Republikën e Shqipërisë dhe kur përdoret në kuptimin gjeografik, nënkupton territorin e Republikës së Shqipërisë, duke përfshirë ujërat territoriale dhe hapësirën ajrore mbi to, si dhe çdo zonë përtej ujërave territoriale të Republikës së Shqipërisë, e cila sipas ligjeve të saj dhe në pajtim me të drejtën ndërkombëtare është një zonë brenda së cilës Republika e Shqipërisë mund të ushtrojë të drejtat e saj në lidhje me shtratin e detit, nëntokën dhe burimet e tyre natyrore;

b) Termi “Spanjë” është Mbretëria e Spanjës dhe nëse përdoret, në kuptimin gjeografik, është territori i Mbretërisë së Spanjës, duke përfshirë ujërat e brendshme, hapësirën ajrore, detin territorial dhe çdo zonë jashtë detit territorial mbi të cilin, në pajtim me të drejtën ndërkombëtare dhe duke zbatuar legjislacionin e brendshëm, Mbretëria e Spanjës ushtron ose mund të ushtrojë në të ardhmen juridiksionin ose të drejta sovraane në lidhje me shtratin detar, nëntokën dhe ujërat sipër saj dhe burimet e tyre natyrore;

c) Termit “një shtet kontraktues” dhe “shteti tjetër kontraktues” është Spanja ose Shqipëria, siç e kërkon konteksti;

d) Termi “person” nënkupton një individ, shoqëri dhe çdo grup tjetër personash;

e) Termi “shoqëri” nënkupton çdo person juridik ose subjekt që trajtohet si person juridik për qëllime tatimore;

f) Termi “ndërmarrje” zbatohet për zhvillimin e një biznesi;

g) Termit “ndërmarrje e një shteti kontraktues” dhe “ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues” nënkuptojnë përkatësisht një ndërmarrje të drejtuar nga një rezident i një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të drejtuar nga një rezident i shtetit tjetër kontraktues;

h) Termi “trafik ndërkombëtar” nënkupton çdo transport me anije ose avion të operuar nga një ndërmarrje që ka vendin e menaxhimit efektiv në një shtet kontraktues, përveç kur anija ose avioni operohen vetëm midis vendndodhjeve në shtetin tjetër kontraktues.

i) Termi “autoritet kompetent” nënkupton:

i) në Shqipëri, Ministrinë e Financave ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;

ii) në Spanjë: Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave ose përfaqësuesin e tij të autorizuar;

j) Termi “shtetas” nënkupton:

i) çdo individ që ka shtetësinë e një shteti kontraktues;

ii) çdo person juridik, ortakëri ose shoqatë që e marrin statusin si të tillë nga ligjet në fuqi në një shtet kontraktues;

k) termi “biznes” përfshin kryerjen e shërbimeve profesionale dhe të aktiviteteve të tjera të një karakteri të pavarur.

2. Përsa i përket zbatimit të Marrëveshjes në çdo kohë nga një shtet kontraktues, çdo term i papërkufizuar në të, për sa kohë që konteksti nuk e kërkon ndryshe, ka kuptimin që ka pasur në atë kohë sipas ligjit të atij Shteti për qëllime tatimore për të cilat zbatohet kjo Marrëveshje; çdo kuptim sipas ligjeve të zbatueshme tatimore të atij shteti ka përparësi mbi një kuptim të dhënë termit sipas ligjeve të tjera të atij shteti.

#### Neni 4

#### **Rezident**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “rezident i një shteti kontraktues” nënkupton çdo person, i cili sipas ligjeve të atij shteti, u nënshtrohet tatimeve përkatëse për shkak të vendbanimit, vendqëndrimit, vendit të menaxhimit, vendit të themelimit, vendit të regjistrimit ose çdo kriteri tjetër të një natyre të ngjashme dhe gjithashtu përfshin atë shtet dhe çdo nënndarje politike ose autoritet lokal të tij. Megjithatë, ky term nuk përfshin asnjë person që i nënshtrohet tatimit në atë shtet vetëm në lidhje me të ardhurat nga burimet në atë shtet.

2. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një individ është rezident në të dyja shtetet kontraktuese, statusi i tij përcaktohet si më poshtë:

a) Ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një banesë të përhershme në dispozicion; nëse ka një banesë të përhershme në dispozicion në të dyja shtetet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit me të cilin ka marrëdhënie më të afërta personale dhe ekonomike (qendra e interesave jetike).

b) Nëse shteti në të cilin ai ka qendrën e interesave të tij jetike nuk mund të përcaktohet, apo nëse ai nuk ka banesë të përhershme në dispozicion të tij në asnjë shtet, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin ka një vendqëndrim të zakonshëm.

c) Nëse ka vendqëndrim të zakonshëm në të dyja shtetet ose në asnjërin prej tyre, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit, shtetas i të cilit ai është.

d) nëse ai është shtetas i të dyja shteteve apo i asnjërit prej tyre, autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese e zgjidhin çështjen me marrëveshje të përbashkët.

3. Kur për shkak të dispozitave të paragrafit 1, një person i ndryshëm nga një individ, është rezident i të dyja shteteve kontraktuese, ai konsiderohet të jetë rezident vetëm i shtetit në të cilin gjendet vendi i menaxhimit efektiv.

#### Neni 5

#### **Seli e përhershme**

1. Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje, termi “seli e përhershme” nënkupton një vend të caktuar biznesi nëpërmjet të cilit zhvillohet biznesi i një ndërmarrjeje në mënyrë të plotë ose të pjesshme.

2. Termi “seli e përhershme” përfshin në veçanti:

a) një vend menaxhimi;

b) një degë;

c) një zyrë;

d) një fabrikë;

e) një punishte; dhe  
f) një minierë, një pus naftë ose gazi, një gurorë ose një vend tjetër të nxjerrjes së burimeve natyrore.

3. Një shesh ndërtimi, një projekt ndërtimi ose instalimi përbën një seli të përhershme vetëm nëse zgjat më shumë se dymbëdhjetë muaj.

4. Pavarësisht nga dispozitat e mësipërme të këtij neni, termi “seli e përhershme” konsiderohet të mos përfshijë:

a) përdorimin e mjediseve vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje të mallrave që i përkasin ndërmarrjes;

b) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllime magazinimi, ekspozimi ose shpërndarjeje;

c) mbajtjen e një rezerve mallrash që i përkasin ndërmarrjes vetëm për qëllim të përpunimit nga një ndërmarrje tjetër;

d) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të blerjes së mallrave ose të mbledhjes së informacionit për ndërmarrjen;

e) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për qëllim të vazhdimit nga ana e ndërmarrjes, të çdo aktiviteti tjetër të një karakteri përgatitor ose ndihmës;

f) mbajtjen e një vendi të caktuar biznesi vetëm për çdo kombinim të aktiviteteve të përmendura në nënparagrafët “a” deri “e”, me kusht që aktiviteti i përgjithshëm i vendit të caktuar të biznesit që rezulton nga ky kombinim, të jetë i një karakteri përgatitor ose ndihmës.

5. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2, kur një person, i ndryshëm nga një agjent me status të pavarur për të cilin zbatohet paragrafi 6, vepron në emër të një ndërmarrjeje dhe ka dhe ushtron rregullisht në një shtet kontraktues autoritet për të lidhur kontrata në emër të ndërmarrjes, ajo ndërmarrje do të konsiderohet të ketë një seli të përhershme në atë Shtet në lidhje me çdo aktivitet që ai person ndërmerr për ndërmarrjen, përveç kur aktivitetet e atij personi janë të kufizuara në ato që përmenden në paragrafin 4, të cilat, nëse ushtrohen nëpërmjet një vendi të caktuar biznesi, nuk do ta bënin këtë të fundit seli të përhershme sipas dispozitave të atij paragrafi.

6. Një ndërmarrje nuk do të konsiderohet të ketë seli të përhershme në një shtet kontraktues vetëm ngaqë zhvillon biznesin në atë shtet nëpërmjet një ndërmjetësi, agjenti me autorizim të përgjithshëm ose çdo agjenti tjetër me status të pavarur, me kusht që ata persona të veprojnë sipas rregullave standarde të biznesit të tyre.

7. Thjesht fakti që, një shoqëri e cila është rezidente e një shteti kontraktues kontrollon ose kontrollon nga një shoqëri e cila është rezidente e shtetit tjetër kontraktues ose që zhvillon biznes në atë shtet tjetër (nëpërmjet një selie të përhershme ose ndryshe), nuk tregon që një prej këtyre shoqërive është seli e përhershme e shoqërisë tjetër.

### KAPITULLI III TATIMI MBI TË ARDHURAT

#### Neni 6

#### **Të ardhurat nga pasuritë e paluajtshme**

1. Të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues nga pasuritë e paluajtshme (duke përfshirë të ardhurat nga bujqësia ose pyjet) që gjenden në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatonen në atë shtet tjetër.

2. Termi “pasuri e paluajtshme” ka kuptimin që ka sipas ligjit të shtetit kontraktues, në të cilin ndodhet pasuria në fjalë. Në çdo rast, termi përfshin pasurinë aksesore të pasurisë së paluajtshme, çdo të drejtë pretendimi në lidhje me pasurinë e paluajtshme, gjënë e gjallë dhe pajisjet e përdorura në bujqësi dhe pylltari, të drejtat për të cilat zbatohen dispozitat e legjislacionit të përgjithshëm në lidhje me tokën, uzufuktin e pasurisë së paluajtshme dhe të drejtat për pagesa të ndryshueshme ose fikse si shpërblim për punën, ose të drejtën për të punuar, depozitat minerare, burimet dhe pasuritë e tjera natyrore; anijet, barkat dhe avionët nuk konsiderohen si pasuri të paluajtshme.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen për të ardhurat që rrjedhin nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose përdorimi në çdo formë tjetër i pasurisë së paluajtshme.

4. Nëse pronësia e aksioneve ose të drejtave të tjera i jep drejtpërdrejt ose jodrejtpërdrejt të drejtën pronarit të këtyre aksioneve ose të drejta të gëzojnë pasurinë e paluajtshme, të ardhurat nga përdorimi i drejtpërdrejtë, dhënia me qira ose në një formë tjetër i gëzimit të kësaj të drejte, mund të tatohet në shtetin kontraktues, në të cilin gjendet pasuria e paluajtshme.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 3 zbatohen gjithashtu për të ardhurat nga pasuria e paluajtshme e një ndërmarrjeje.

#### Neni 7

### **Fitimet nga biznesi**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues janë të tatueshme vetëm në atë shtet, përveç kur ndërmarrja zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje. Nëse ndërmarrja zhvillon biznes si më sipër, fitimet e ndërmarrjes mund të tatohen në shtetin tjetër, por vetëm për ato që i takojnë asaj selie të përhershme.

2. Në bazë të dispozitave të paragrafit 3, kur një ndërmarrje e një shteti kontraktues zhvillon biznes në shtetin tjetër kontraktues, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur atje, fitimet, të cilat mund të pritej të nxirte nëse do të ishte një ndërmarrje e veçantë dhe e ndarë, e përfshirë në aktivitete të njëjta ose të ngjashme, sipas kushteve të njëjta ose të ngjashme dhe që ka marrëdhënie tërësisht të pavarura me ndërmarrjen seli e përhershme, e së cilës ajo është në secilin shtet kontraktues do t'i atribuohen asaj selie të përhershme.

3. Në përcaktimin e fitimeve të një selie të përhershme, lejohen si zbritje shpenzimet që janë bërë për qëllime të biznesit të selisë së përhershme, duke përfshirë shpenzimet ekzekutive dhe të përgjithshme administrative të kryera në shtetin ku ndodhet selia e përhershme ose gjetkë.

4. Asnjë fitim nuk i atribuohet një selie të përhershme për shkak vetëm të blerjes nga ajo seli e përhershme të mallrave për ndërmarrjen.

5. Për qëllime të paragrafëve të mësipërm, fitimet që i atribuohen selisë së përhershme, përcaktohen me anë të së njëjtës metodë vit pas viti, për sa kohë që nuk ka arsye të fortë dhe të mjaftueshme për të kundërtën.

6. Kur fitimet përfshijnë zërat e të ardhurave që rregullohen veçmas në nenet e tjera të kësaj Marrëveshjeje, dispozitat e atyre neneve nuk do të cenohen nga dispozitat e këtij neni.

#### Neni 8

### **Transporti detar dhe ajror**

1. Fitimet e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues nga operimi i anijeve dhe avionëve në trafikun ndërkombëtar janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues ku gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

2. Nëse vendi i menaxhimit efektiv të një ndërmarrjeje anijesh është në bordin e një anijeje, ai konsiderohet të jetë në shtetin kontraktues ku gjendet porti i vendit të anijes, ose, nëse nuk ka port të tillë, në shtetin kontraktues ku është rezident operatori i anijes.

3. Dispozitat e paragrafit 1 zbatohen gjithashtu për fitimet nga pjesëmarrja në një ortakëri, biznes të përbashkët ose agjenci operuese ndërkombëtare.

#### Neni 9

### **Ndërmarrjet e asociuara**

1. Në rastet kur:

a) një ndërmarrje e një shteti kontraktues merr pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues; ose

b) të njëjtët persona marrin pjesë në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo në menaxhimin, kontrollin ose kapitalin e një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues dhe një ndërmarrjeje të shtetit tjetër kontraktues;

dhe kur në çdo rast janë caktuar ose vendosur kushte ndërmjet dy ndërmarrjeve në marrëdhëniet e tyre tregtare ose financiare që ndryshojnë nga ato që do të vendoseshin midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë çdo fitim, që në mungesë të atyre kushteve, do t'i ishte shtuar një prej ndërmarrjeve, por për shkak të atyre kushteve nuk është shtuar, mund të përfshihet në fitimet e asaj ndërmarrjeje dhe të tatonet përkatësisht.

2. Kur një shtet kontraktues përfshin në fitimet e një ndërmarrjeje të atij shteti dhe taton përkatësisht, fitimet për të cilat një ndërmarrje e shtetit tjetër kontraktues është tatur në atë shtet tjetër dhe kur një pjesë e fitimeve të përfshira janë fitimet, të cilat do t'i ishin shtuar ndërmarrjes së shtetit të përmendur më parë, nëse kushtet e vendosura midis dy ndërmarrjeve do të kishin qenë ato që do të ishin vendosur midis ndërmarrjeve të pavarura, atëherë shteti tjetër do të bëjë një rregullim të përshtatshëm ndaj sasisë së tatimeve të vëna në të mbi ato fitime. Në përcaktimin e këtij rregullimi, duhet t'u kushtohet vëmendje dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje dhe autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese, nëse është e nevojshme, konsultohen me njëri-tjetrin.

## Neni 10 Dividendët

1. Dividendët e paguar nga një firmë që është rezidente e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatonen në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, këta dividendë mund të tatonen gjithashtu në shtetin kontraktues, në të cilin është rezidente firma që paguan dividendët dhe sipas ligjeve të atij shteti, por nëse pronari përfitues i dividendëve është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë:

a) 0 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga ortakëri) që ka drejtpërdrejt të paktën 75 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

b) 5 për qind të shumës bruto të dividendëve, nëse pronari përfitues është një shoqëri (e ndryshme nga ortakëri) që ka drejtpërdrejt të paktën 10 për qind të kapitalit të shoqërisë që paguan dividendët;

c) 10 për qind të shumës bruto të dividendëve në të gjitha rastet e tjera.

Ky paragraf nuk cenon tatimin e shoqërisë në lidhje me fitimet nga të cilat paguhen dividendët.

3. Termi “dividendë” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga aksionet, aksionet e “gëzimit” ose të drejtat e “gëzimit”, aksionet e minierave, aksionet e themeluesve ose të drejta të tjera, që nuk janë detyrime borxhi, që marrin pjesë në fitime dhe të ardhura, të cilat i nënshtrohen të njëjtit trajtim tatimor si të ardhurat nga aksionet nga ligjet e shtetit, në të cilin firma që bën shpërndarjen është rezidente.

4. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i dividendëve, duke qenë rezident i një shteti kontraktues zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues, në të cilin shoqëria që paguan dividendët është rezidente, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët është efektivisht e lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

5. Kur një shoqëri, e cila është rezidente e një shteti kontraktues nxjerr fitime ose të ardhura nga shteti tjetër kontraktues, ai shtet tjetër nuk mund të vendosë ndonjë tatim mbi dividendët e paguar nga firma, përveç rasteve kur këta dividendë i paguhen një rezidenti të atij shteti tjetër ose për sa kohë që pjesëmarrja në lidhje me të cilën paguhen dividendët, është efektivisht e lidhur me selinë e përhershme të vendosur në atë shtet tjetër dhe as nuk do t'i nënshtrojë fitimet e pashpërndara të shoqërisë një tatimi mbi fitimet e pashpërndara të shoqërisë, edhe nëse dividendët e paguar ose fitimet e pashpërndara përbëhen tërësisht ose pjesërisht prej fitimeve ose të ardhurave të nxjerra në atë shtet tjetër.

## Neni 11 Interesi

1. Interesi i nxjerrë në një shtet kontraktues dhe i paguar një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohet në atë shtet tjetër.

2. Megjithatë, ky interes mund të tatohet në shtetin kontraktues në të cilin ai lind dhe sipas ligjeve të atij shteti, por, nëse pronari përfitues i interesit është rezident i shtetit tjetër kontraktues, tatimi i vendosur nuk do të tejkalojë 6 për qind të shumës bruto të interesit.

3. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 2, interesi që lind në një shtet kontraktues dhe i paguhet një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues tatohet vetëm në atë shtet tjetër nëse marrësi është pronari përfitues i interesit dhe:

- a) është ai shtet ose banka qendrore, një nënndarje politike apo autoriteti lokal i tij;
- b) interesi paguhet nga shteti në të cilin lind interesi ose nga një nënndarje politike, ose autoritet lokal apo organ ligjor i tij;
- c) interesi paguhet në lidhje me një hua, pretendim borxhi ose kredi që është marrë, dhënë, garantuar ose siguruar nga ai shtet apo një nënndarje politike, autoritet lokal apo agjenci financiare eksporti e tij;
- d) është një institucion financiar;
- e) interesi paguhet në lidhje me qenien në borxh të shkaktuar si pasojë e shitjes me kredi të një pajisjeje, malli apo shërbimi;
- f) është një fond pensioni që aprovohet për qëllime tatimore nga ai shtet dhe të ardhurat e atij fondi përgjithësisht janë përjashtuar nga tatimi në atë shtet.

4. Termi “interes” siç përdoret në këtë nen, nënkupton të ardhurat nga detyrimet e borxhit të çdo lloji, i siguruar apo jo me hipotekë dhe nëse ka apo jo të drejtë për të marrë pjesë në fitimet e debitorit dhe në veçanti, të ardhurat nga letrat me vlerë qeveritare dhe të ardhurat nga obligacionet ose dëftesat e borxhit, duke përfshirë premiet dhe çmimet që u bashkëngjiten këtyre letrave me vlerë, obligacioneve dhe dëftesave të borxhit, si dhe të gjitha të ardhurat e tjera të asimiluara në të ardhura nga paratë e dhëna nga ligjet tatimore të shtetit ku lindin të ardhurat. Gjjobat për vonesat në pagesa nuk llogariten si interes për qëllimet e këtij neni.

5. Dispozitat e paragrafëve 1 2 dhe 3 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i interesit, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues, në të cilin lind interesi nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe detyrimi i borxhit, në lidhje me të cilin është paguar interesi është efektivisht i lidhur me këtë seli të përhershme. Në këtë rast zbatohen dispozitat e nenit 7.

6. Interesi konsiderohet të lindë në një shtet kontraktues kur paguesi është vetë shteti, një nënndarje politike, një autoritet lokal ose një rezident i atij shteti. Megjithatë, kur një person që paguan interesin, qoftë rezident i shtetit kontraktues apo jo, ka në një shtet kontraktues një seli të përhershme, në lidhje me të cilën ka ndodhur mbetja e borxhit, mbi të cilën është paguar interesi dhe ky interes përballohet nga kjo seli e përhershme, atëherë, interesi konsiderohet të lindë në shtetin në të cilin ndodhet selia e përhershme.

7. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shuma e interesit, duke marrë parasysh detyrimin e borxhit për të cilin paguhet, tejkalon shumën, e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, do të zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave do të mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

## Neni 12 Tarifat e licencave

1. Tarifat e licencave që lindin në një shtet kontraktues dhe që i paguhet një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Termi “tarifat e licencave” siç përdoret në këtë nen, nënkupton pagesat e çdo lloji të marra si shpërblim për përdorimin ose të drejtën e përdorimit të çdo të drejte autori të veprës letrare, artistike ose shkencore, duke përfshirë filmat kinematografikë dhe regjistrimet për radion dhe televizionin, çdo patentë, markë tregtare, dizeno ose model, plan, formulë sekrete ose proces ose për përdorimin e, ose për të drejtën e përdorimit të pajisjeve industriale, tregtare ose shkencore ose për informacion në lidhje me përvojën industriale, tregtare ose shkencore.

3. Dispozitat e paragrafit 1 nuk zbatohen nëse pronari përfitues i tarifave të licencave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues, në të cilin lindin tarifat e licencave, nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen tarifat e licencave është e lidhur efektivisht me këtë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

4. Kur për shkak të një marrëdhënieje të veçantë ndërmjet paguesit dhe pronarit përfitues ose ndërmjet të dyve dhe një personi tjetër, shumica e tarifave të licencave, duke marrë në konsideratë përdorimin, të drejtën ose informacionin për të cilin ato janë paguar, tejkalon shumën e cila do të ishte rënë dakord nga paguesi dhe pronari përfitues në mungesë të kësaj marrëdhënieje, zbatohen dispozitat e këtij neni vetëm për shumën e përmendur së fundi. Në këtë rast, pjesa e tepërt e pagesave mbetet e tatueshme sipas ligjeve të secilit shtet kontraktues, duke u kushtuar vëmendjen e duhur dispozitave të tjera të kësaj Marrëveshjeje.

#### Neni 13

#### **Fitimet e kapitalit**

1. Fitimet e nxjerra nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i pasurisë së paluajtshme të përmendur në nenin 6 dhe të ndodhur në shtetin tjetër kontraktues, mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Fitimet nga tjetërsimi i pasurisë së luajtshme që përbëjnë pjesë të pasurisë së biznesit të një selie të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, duke përfshirë fitimet nga tjetërsimi i kësaj selie të përhershme (vetëm ose me të gjithë ndërmarrjen), mund të taten në atë shtet tjetër.

3. Fitimet nga tjetërsimi i anijeve ose avionëve që operohen në trafikun ndërkombëtar ose i pasurive të luajtshme që i përkasin operimit të këtyre anijeve ose avionëve taten vetëm në shtetin kontraktues ku gjendet vendi i menaxhimit efektiv të ndërmarrjes.

4. Fitimet e përfuara nga një rezident i një shteti kontraktues nga tjetërsimi i aksioneve ose interesave të krahasueshme, që marrin më shumë se 50 për qind të vlerës së tyre drejtpërdrejt ose jo nga pasuria e paluajtshme që gjendet në shtetin tjetër kontraktues mund të taten në atë shtet tjetër.

5. Fitimet nga tjetërsimi i aksioneve ose të drejtave të tjera që i japin të drejtë drejtpërdrejt ose jo pronarit të këtyre aksioneve, ose të drejtave për gëzimin e pasurisë së paluajtshme që gjendet në një shtet kontraktues, mund të taten nga ai shtet.

6. Fitimet nga tjetërsimi i çdo pasurie, e ndryshme nga ajo e përmendur në paragrafët 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij neni, janë të tatueshme vetëm në shtetin kontraktues, rezident i të cilit është tjetërsuesi.

#### Neni 14

#### **Të ardhurat nga punësimi**

1. Në bazë të dispozitave të nenit 15, 17 dhe 18, rrogat, pagat dhe shpërblimet e tjera të ngjashme që përfitohen nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet, nëse punësimi nuk ushtrohet në shtetin tjetër kontraktues. Nëse punësimi ushtrohet në këtë mënyrë, ky shpërblim që përfitohet atje mund të taten në atë shtet tjetër.

2. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 1, shpërblimi i përfuar nga një rezident i një shteti kontraktues në lidhje me një punësim të ushtruar në shtetin tjetër kontraktues, do të jetë i tatueshëm vetëm në shtetin e përmendur më parë, nëse:



a) marrësi është i pranishëm në Shtetin tjetër për një periudhë ose periudha që nuk i tejkalojnë në total 183 ditë në çdo periudhë dymbëdhjetë mujore, e cila fillon ose përfundon në vitin fiskal përkatës; dhe

b) shpërblimi paguhet nga ose në emër të një punëdhënësi, i cili nuk është rezident i shtetit tjetër; dhe

c) shpërblimi nuk përballohet nga një vendqëndrim i përhershëm të cilën punëdhënësi e ka në shtetin tjetër.

3. Pavarësisht dispozitave të mësipërme të këtij neni, shpërblimi i përfutur në lidhje me një punësim të ushtruar në bordin e një anijeje ose avioni të operuar në trafikun ndërkombëtar mund të tatohet në shtetin kontraktues ku gjendet menaxhimi efektiv i ndërmarrjes.

#### Neni 15

#### **Tarifat e drejtuesve**

Tarifat e drejtuesve dhe pagesa të tjera të ngjashme që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në cilësinë e tij si anëtar i bordit të drejtuesve të një shoqërie ose të një organi të ngjashëm me të njëjtat funksione në një shoqëri që është rezidente e shtetit tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

#### Neni 16

#### **Artistët dhe sportistët**

1. Pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, të ardhurat që përftohen nga një rezident i një shteti kontraktues në rolin e argëtuesit si: teatër, film, artist radioje ose televizioni, muzikant apo sportist, nga aktivitetet personale të këtij personi të ushtruara në këtë mënyrë në shtetin tjetër kontraktues, mund të tatohen në atë shtet tjetër.

2. Kur të ardhurat në lidhje me aktivitetet personale të ushtruara nga një argëtues ose sportist në cilësinë e tij, si të tillë nuk përftohen nga subjekti argëtues ose sportisti por nga një person tjetër, ato të ardhura, pavarësisht nga dispozitat e neneve 7 dhe 14, mund të tatohen në shtetin kontraktues në të cilin ushtrohen aktivitetet e argëtuesit apo sportistit.

3. Dispozitat e paragrafëve 1 dhe 2 nuk zbatohen nëse aktivitetet e ushtruara nga një argëtues ose sportist në një shtet kontraktues mbështeten tërësisht ose pjesërisht nga fondet publike të një shteti kontraktues ose nënndarje politike ose autoritet lokal i tij, në kuadrin e një programi shkëmbimi kulturor ose sportiv të aprovuar nga të dy shtetet kontraktues. Në këtë rast, të ardhurat tatohen në shtetin kontraktues në të cilin është rezident artisti ose sportisti.

#### Neni 17

#### **Pensionet**

Në pajtim me dispozitat e paragrafit 2 të nenit 18, pensionet dhe shpërblime të ngjashme të paguara një rezidenti të një shteti kontraktues në lidhje me punësimin e shkuar do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

#### Neni 18

#### **Shërbimi qeveritar**

1.a) Rrogat, pagat dhe shpërblime të tjera të ngjashme, të paguara nga një shtet kontraktues ose nënndarje politike, autoritet lokal i tij kundrejt një individi në lidhje me shërbimet e kryera për atë shtet ose nënndarje apo autoritet, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

b) Megjithatë, këto paga, ose shpërblime të tjera të ngjashme do të jenë të tatueshme vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse shërbimet kryhen në atë shtet dhe nëse individi është rezident i atij shteti dhe që:

i) është shtetas i atij shteti, ose

ii) nuk është bërë rezident i atij shteti vetëm për qëllim të kryerjes së shërbimeve.

2.a) Pavarësisht dispozitave të paragrafit 1, pensionet dhe shpërblimet e tjera që paguhen nga fondet e ngritura nga një shtet kontraktues ose një nënndarje politike apo autoritet lokal i tij për një individ në lidhje me shërbimet që jepen në atë shtet ose nënndarje apo autoritet, taten vetëm në atë shtet;

b) Megjithatë, këto pensione ose shpërblime të tjera të ngjashme taten vetëm në shtetin tjetër kontraktues, nëse individi është një rezident apo shtetas i atij shteti.

3. Dispozitat e neneve 14, 15, 16, dhe 17 do të zbatohen për rrogat, pagat, pensionet dhe shpërblime të tjera të ngjashme, në lidhje me shërbimet e kryera për një biznes të zhvilluar nga një shtet kontraktues ose nënndarje politike apo autoritet lokal i tij.

#### Neni 19

#### **Studentët dhe stazhierët**

1. Pagesat që merr një student, nxënës ose stazhier, i cili është ose ka qenë menjëherë para vizitës në shtetin kontraktues rezident i shtetit tjetër kontraktues dhe është i pranishëm në shtetin e parë vetëm për qëllime të edukimit ose trajnimit të tij, për qëllimet e mbështetjes ekonomike, edukimit ose trajnimit të tij, nuk do të taten në atë shtet, me kusht që këto pagesa të lindin nga burime jashtë atij shteti.

2. Në lidhje me grandet, bursat dhe shpërblimet nga punësimi që nuk mbulohen nga paragrafi 1, një student ose stazhier i përshkruar në paragrafin 1 ka po ashtu të drejtën gjatë këtij edukimi ose trajnimit, e të njëjtave përjashtimeve, uljeve dhe lehtësimeve në lidhje me tatimet që u vihen rezidentëve të atij shteti që ai po viziton.

#### Neni 20

#### **Të ardhura të tjera**

1. Zërat e të ardhurave të një rezidenti të një shteti kontraktues, kudo që lindin, të pajtuara në nenet e mësipërm të kësaj Marrëveshje, do të jenë të tatueshme vetëm në atë shtet.

2. Dispozitat e paragrafit 1, nuk do të zbatohen për të ardhurat e ndryshme nga të ardhurat nga pasuria e paluajtshme, siç përcaktohet në paragrafin 2 të nenit 6, nëse marrësi i këtyre të ardhurave, duke qenë rezident i një shteti kontraktues, zhvillon biznesin në shtetin tjetër kontraktues nëpërmjet një selie të përhershme të vendosur në të dhe e drejta ose pasuria në lidhje me të cilat paguhen të ardhurat është efektivisht e lidhur me atë seli të përhershme. Në këtë rast, zbatohen dispozitat e nenit 7.

### KAPITULLI IV

### METODAT PËR ELIMINIMIN E TATIMIT TË DYFISHTË

#### Neni 21

#### **Eliminimi i tatimit të dyfishtë**

1. Në Shqipëri:

a) Nëse një rezident i Shqipërisë përfton të ardhura që në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshje, mund të taten në Spanjë, Shqipëria lejon si zbritje nga tatimi shqiptar mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në Spanjë.

Megjithatë, kjo zbritje nuk tejkalon atë pjesë të tatimit shqiptar mbi të ardhurat që llogariten para se të bëhet zbritja që, sipas rasti, u përket të ardhurave që mund të taten në Spanjë.

b) Nëse në pajtim me një dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e përftuara nga një rezident i Shqipërisë përjashtohen nga tatimet në Shqipëri, Shqipëria, megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

2. Në Spanjë, tatimi i dyfishtë shmanget si më poshtë duke respektuar dispozitat e legjislacionit të saj të brendshëm ose duke respektuar dispozitat në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Spanjës:

a) Nëse një rezident i Spanjës merr të ardhura, që në pajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, mund të taten në Shqipëri, Spanja lejon:

i) si zbritje nga tatimi mbi të ardhurat e atij rezidenti, një shumë të barabartë me tatimin mbi të ardhurat të paguara në Shqipëri;

ii) zbritja e tatimit korporativ bazë bëhet në pajtim me legjislacionin e brendshëm të Spanjës.

Një zbritje e tillë nuk e kalon atë pjesë të tatimeve mbi të ardhurat që llogaritet para se të bëhet zbritja, që u takon të ardhurave që mund të taten në Shqipëri.

b) Nëse në pajtim me një dispozitë të Marrëveshjes, të ardhurat e përfuara nga një rezident i Spanjës përjashtohen nga tatimet në Spanjë, Spanja, megjithatë, në llogaritjen e shumës së tatimit mbi të ardhurat e mbetura të këtij rezidenti, merr parasysh të ardhurat e përjashtuara.

## KAPITULLI V DISPOZITA TË VEÇANTA

### Neni 22

#### **Mosdiskriminimi**

1. Shtetasit e një shteti kontraktues nuk i nënshtrohen në shtetin tjetër kontraktues tatimit ose çdo kërkesë në lidhje me atë që ndryshon ose është më e rëndë se sa tatimi dhe kërkesat përkatëse ndaj të cilave shtetasit e atij shteti tjetër nënshtrohen ose mund të nënshtrohen në të njëjtat rrethana, veçanërisht në lidhje me rezidencën. Kjo dispozitë, pavarësisht dispozitave të nenit 1, zbatohet edhe për personat që nuk janë rezidentë të një ose të dy shteteve kontraktues.

2. Tatimi mbi një seli të përhershme që një ndërmarrje e një shteti kontraktues ka në shtetin tjetër kontraktues, nuk do të vendoset në mënyrë më pak të favorshme në atë shtet tjetër sesa tatimi i vendosur mbi ndërmarrjet e atij shteti tjetër që zhvillon të njëjtat aktivitete. Kjo dispozitë nuk interpretohet sikur detyron një shtet kontraktues t'u japë rezidentëve të shtetit tjetër kontraktues çdo përfitim personal, lehtësim ose ulje për qëllime tatimore për shkak të gjendjes civile ose përgjegjësisë familjare që ai u jep rezidentëve të tij.

3. Përveç rasteve kur zbatohen dispozitat e paragrafit 1 të nenit 9, paragrafit 7 të nenit 11 ose të paragrafit 4 të nenit 12, interesi, tarifat e licencave dhe disbursime të tjera të paguara nga një ndërmarrje e një shteti kontraktues një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllim të përcaktimit të fitimeve të tatueshme të kësaj ndërmarrjeje, do të jenë të zbritshme sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin paguar një rezidenti të shtetit të përmendur më parë. Po kështu, çdo borxh i një ndërmarrjeje të një shteti kontraktues ndaj një rezidenti të shtetit tjetër kontraktues, për qëllimin e përcaktimit të kapitalit të tatueshëm të një ndërmarrjeje të tillë, është i tatueshëm sipas të njëjtave kushte sikur t'i ishin kontraktuar një rezidenti të shtetit të parë.

4. Ndërmarrjet e një shteti kontraktues, kapitali i të cilave është në pronësi ose zotërohet tërësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo jo nga një ose më shumë rezidentë të shtetit tjetër kontraktues, nuk i nënshtrohen asnjë tatimi në shtetin e përmendur më parë dhe asnjë kërkesë në lidhje me të, që është e ndryshme ose më e rëndë se tatimi dhe kërkesat e ngjashme të cilave mund t'i nënshtrohen ndërmarrje të tjera të ngjashme të shtetit të përmendur më parë.

5. Dispozitat e këtij neni, pavarësisht dispozitave të nenit 2, do të zbatohen për tatime të çdo lloji.

### Neni 23

#### **Procedura e Marrëveshjes së ndërsjellë**

1. Kur një person konsideron se, veprimet e një ose të dy shteteve kontraktuese rezultojnë ose do të rezultojnë për të në tatim në mospajtim me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje, pavarësisht nga mjetet e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm i atyre shteteve, ai mund t'ia paraqesë çështjen e tij autoritetit kompetent të shtetit kontraktues në të cilin është rezident ose nëse çështja e tij trajtohet në paragrafin 1 të nenit 23, të shtetit kontraktues, në të cilin është shtetas. Çështja mund të paraqitet brenda tre vjetësh nga njoftimi i parë i veprimit që rezulton në tatimin në mospajtim me dispozitat e Marrëveshjes.

2. Autoriteti kompetent, nëse mendon që kundërshtimi është i bazuar dhe nëse nuk është vetë në gjendje për të arritur një zgjidhje të pranueshme, përpiqet të zgjidhë me anë të marrëveshjes së ndërsjellë me autoritetin kompetent të shtetit tjetër kontraktues, me qëllim mënjanimin e tatimit që nuk është në pajtim me këtë Marrëveshje. Çdo marrëveshje e arritur zbatohet pavarësisht afateve kohore në ligjin e brendshëm të shteteve kontraktuese.

3. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese përpiqen të zgjidhin me anë të marrëveshjes së ndërsjellë çdo vështirësi ose dyshim që lind në lidhje me interpretimin ose zbatimin e Marrëveshjes. Ata gjithashtu, mund të konsultohen së bashku për eliminimin e tatimit të dyfishtë në rastet të cilat nuk janë parashikuar në Marrëveshje.

4. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese mund të komunikojnë me njëri-tjetrin në mënyrë të drejtpërdrejtë, për qëllim arritjen e një marrëveshjeje në kuptimin e paragrafëve të mësipërm. Nëse duket e arsyeshme që, për arritjen e marrëveshjes duhet të bëhen shkëmbime gojore mendimesh, këto shkëmbime mund të realizohen nëpërmjet një komisioni që përbëhet nga përfaqësues të autoriteteve kompetente të shteteve kontraktuese.

## Neni 24

### **Shkëmbimi i informacionit**

1. Autoritetet kompetente të shteteve kontraktuese shkëmbejnë informacionin që mendohet i nevojshëm për zbatimin e dispozitave të kësaj marrëveshjeje, për administrimin apo zbatimin e ligjeve të brendshme në lidhje me tatimet e çdo lloji dhe përshkrimi të vendosur në emër të shteteve kontraktuese, nënndarjeve politike ose autoriteteve lokale, në masën që tatimi sipas tyre nuk është në kundërshtim me Marrëveshjen. Shkëmbimi i informacionit nuk kufizohet nga nenet 1 dhe 2.

2. Çdo informacion i marrë sipas paragrafit 1 nga një shtet kontraktues trajtohet si konfidencial në të njëjtën mënyrë si informacioni i përfutur sipas ligjeve të brendshme të atij shteti dhe u deklarohet vetëm personave ose autoriteteve (duke përfshirë gjykatat dhe organet administrative) që merren me vlerësimin ose mbledhjen, zbatimin ose procedimin në lidhje me ose përcaktimin e ankimeve në lidhje me tatimet e përmendura në paragrafin 1, ose mbikëqyrjen sa më sipër. Këta persona ose autoritete e përdorin informacionin vetëm për këto qëllime. Ata mund ta deklarojnë informacionin në gjykime me dyer të hapura ose vendime gjyqësore.

3. Pavarësisht sa më sipër, informacioni i marrë nga një shtet kontraktues mund të përdoret për qëllime të tjera kur ky informacion mund të përdoret për ato qëllime të tjera sipas ligjit të shtetit kërkues.

Në asnjë rast, dispozitat e paragrafit 1 dhe 2 nuk interpretohen sikur vendosin mbi një shtet kontraktues detyrimin:

a) për të realizuar masa administrative në mospajtim me ligjet dhe praktikën administrative të atij ose të shtetit tjetër kontraktues;

b) të japë informacion që nuk është i përfutueshëm sipas ligjeve ose në punën normale të administrimit në atë ose shtetin tjetër kontraktues;

c) të japë informacion që do të zbulonte një sekret tregtar, biznesi, industrial ose profesional ose proces tregtar apo informacion, zbulimi i të cilit do të ishte në kundërshtim me politikën publike (rendin publik).

4. Nëse informacioni kërkohet nga një shtet kontraktues në pajtim me këtë nen, shteti tjetër kontraktues zbaton masat për mbledhjen e informacionit të kërkuar edhe nëse këtij shteti nuk i duhet ky informacion për qëllimet e veta tatimore. Detyrimi i parashikuar në fjalinë e mësipërme i nënshtrohet kufizimit të paragrafit 3, por në asnjë rast këto kufizime nuk interpretohen sikur lejojnë një shtet kontraktues të mos japë informacion vetëm pasi ai nuk ka interes të brendshëm për këtë informacion.

5. Në asnjë rast, dispozita e paragrafit 3 nuk interpretohet sikur lejon një shtet kontraktues të mos japë informacion vetëm pasi informacioni zotërohet nga një bankë, institucion tjetër financiar, i emëruar ose person që vepron në një agjenci ose cilësi mirëbesimi apo për shkak se ka të bëjë me interesa pronësie të një personi.

## Neni 25

### **Anëtarët e misioneve diplomatike dhe posteve konsullore**

Asgjë në këtë Marrëveshje nuk cenon privilegjet fiskale të anëtarëve të misioneve diplomatike ose posteve konsullore sipas rregullave të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare ose sipas dispozitave të marrëveshjeve të veçanta.

## KAPITULLI VI DISPOZITA TË FUNDIT

### Neni 26

#### **Hyrja në fuqi**

1. Secili shtet kontraktues njofton tjetrin nëpërmjet kanaleve diplomatike që është përmbushur procedura e brendshme që kërkohet nga secili shtet kontraktues për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas një periudhe prej tre muajsh pas datës së marrjes së njoftimit të fundit të përmendur në paragrafin 1 dhe dispozitat e saj do të kenë fuqi:

i) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, mbi shumat e paguara ose kredituara jorezidentëve, në ose pas datës në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja;

ii) në lidhje me tatimet e tjera, për vitet tatimore që fillojnë në ose pas datës në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja.

iii) në të gjitha rastet e tjera, në ose pas datës në të cilën hyn në fuqi Marrëveshja.

### Neni 27

#### **Përfundimi**

Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi deri sa të ndërpritet nga një shtet kontraktues. Secili shtet kontraktues mund ta ndërpresë Marrëveshjen, nëpërmjet kanaleve diplomatike, duke bërë njoftim me shkrim për përfundimin të paktën gjashtë muaj para fundit të çdo viti kalendarik pas skadimit të një periudhe pesëvjeçare nga data e hyrjes së saj në fuqi. Në një rast të tillë, Marrëveshja pushon së qeni në fuqi:

i) në lidhje me tatimet e mbajtura në burim, mbi shumat e paguara ose kredituara jorezidentëve, pas fundit të atij viti kalendarik;

ii) në lidhje me tatimet e tjera, për vitet tatimore, pas fundit të atij viti kalendarik; dhe

iii) në të gjitha rastet e tjera, pas fundit të atij viti kalendarik.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Tiranë më 2 korrik 2010, në gjuhën shqipe, spanjolle dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëllorj autentike. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve, kjo zgjidhet në pajtim me procedurën e rregulluar në nenin 23 të kësaj Marrëveshjeje.

Për Republikën e Shqipërisë  
Ilir Meta  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër  
i Punëve të Jashtme

Për Mbretërinë e Spanjës  
Manuel Montobio  
Ambasador Spanjës në Tiranë

## PROTOKOLL

Në momentin e nënshkrimit të Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Spanjës për shmangien e tatimit të dyfishtë dhe parandalimin e evazionit fiskal në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, të poshtëshënuarit kanë rënë dakord për dispozitat e mëposhtme që do të jenë pjesë përbërëse e Marrëveshjes.

## I. Interpretimi i Marrëveshjes

Dihet që dispozitat e Marrëveshjes janë hartuar në pajtim me dispozitat përkatëse të Konventës Model të OECD-së mbi të ardhurat dhe kapitalin do të interpretohen në pajtim me Komentet e OECD-së për këtë. Komentet që mund të rishiten herë pas here, përbëjnë një mjet interpretimi në kuptimin e Konventës së Vjenës të datës 23 maj 1969 mbi të drejtën e traktateve.

## II. E drejta për përfitimet nga traktatet

a) Kjo Marrëveshje nuk interpretohet sikur parashikon që një shtet kontraktues pengohet në zbatimin e dispozitave të tij ligjore të brendshme për parandalimin e evazionit fiskal ose shmangien e tatimeve.

b) Shtetet kontraktuese deklarojnë që rregullat dhe procedurat e tyre të brendshme në lidhje me abuzimet ligjore (duke përfshirë traktatet tatimore) mund të zbatohen për trajtimin e këtyre abuzimeve.

c) Kjo Marrëveshje nuk pengon shtetet kontraktues të zbatojnë rregullat e brendshme për shoqëritë e huaja të kontrolluara.

d) Dispozitat e neneve 10, 11 dhe 12 nuk zbatohen nëse ka qenë qëllimi kryesor ose një nga qëllimet kryesore për një person të interesuar për krijimin ose transferimin e aksioneve ose të drejtave të tjera në lidhje me të cilat paguhen dividendë, krijimi ose transferimi i pretendimit të borxhit në lidhje me të cilin paguhet interesi, krijimi ose transferimi i të drejtave në lidhje me të cilat paguhen tarifatat e licencave për të përfituar nga këto nene nëpërmjet krijimit ose transferimit.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në dy kopje në Tiranë më 2 korrik 2010, në gjuhën shqipe, spanjolle dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëjloj autentike. Në rast mospërputhjeje ndërmjet teksteve, kjo zgjidhet në pajtim me procedurën e rregulluar në Nenin 23 të kësaj Marrëveshjeje.

Për Republikën e Shqipërisë  
Ilir Meta  
Zëvendëskryeministër dhe Ministër  
i Punëve të Jashtme

Për Mbretërinë e Spanjës  
Manuel Montobio  
Ambasador i Spanjës në Tiranë

## VENDIM

**Nr.855, datë 21.10.2010**

### **PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.586, DATË 7.7.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KUOTAT E PRANIMIT NË INSTITUCIONET PUBLIKE TË ARSIMIT TË LARTË, CIKLI I PARË I STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË, SI DHE PËR TARIFAT E SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2010-2011”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të pikës 2 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 33, 35, 36 e 75 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në pikën 9, të vendimit nr.586, datë 7.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, pas fjalëve “... apo fëmijëve të policëve ...” shtohen “... dhe ushtarakëve të Forcave të Armatosura...”.

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes dhe Ministri i Arsimit dhe Shkencës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**VENDIM**  
**Nr.856, datë 21.10.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE,  
SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË  
KOMUNËS PETRELË, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Petrelë, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Petrelë, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.181, datë 19.2.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Petrelë, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Petrelë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Sali Berisha

**Komuna Petrelë**

<b>Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit</b>	<b>Fusha e përdorimit të pronës</b>	<b>Lloji i transferimit</b>
263-276	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të arsimit.	Në pronësi
277-281	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë.	Në pronësi
282-301	Shërbime funerale	Në pronësi
302-336, 372-520	Infrastrukturë (rrugë vendore, lulishte, sheshe) dhe shërbime publike.	Në pronësi
521, 525, 526, 529	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore produktive).	Në përdorim
522-524, 527, 528	Prona që përdoren në fushën e bujqësisë (tokë bujqësore joproduktive).	Në përdorim
344-371 (vetëm kanalet e treta)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e kullimit dhe ujitjes.	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr.857, datë 21.10.2010**

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË BASHKISË KONISPOL, TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Konispol, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Konispol të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.662, datë 11.6.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të bashkisë Konispol, të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Konispol për zbatimin e këtij vendimi.  
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Bashkia Konispol	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
5-10	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
13, 14	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore, historike e sportive	Në pronësi
23-26	Varreza publike	Në pronësi
27, 28, 29	Troje të lira dhe hapësira publike të pa zëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
30-36	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile	Në pronësi
39	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi
40-51	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
108	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproductive).	Në pronësi



**VENDIM**  
**Nr.859, datë 27.10.2010**

**PËR NJË SHITESË NË LISTËN PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS DRENOVË, TË QARKUT TË KORÇËS, MIRATUAR ME VENDIMIN NR.742, DATË 8.9.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Miratimin e shtesës në listën përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Drenovë, të qarkut të Korçës, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, miratuar me vendimin nr.742, datë 8.9.2010, të Këshillit të Ministrave, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista e inventarit me 93 (nëntëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 573 (pesëqind e shtatëdhjetë e tre).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Drenovë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Komuna Drenovë	Lidhja nr.1	
Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
277-278,283-289, 292, 296, 298, 303-304, 312, 535-573	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e pyje dhe kullota	Në pronësi

**VENDIM**  
**Nr.860, datë 27.10.2010**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TOKË TRUALL DHE OBJEKTE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “PORTO ROMANO-DURRËS, LOTI I”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit për vitin 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, tokë truall dhe objekte, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Porto Romano-Durrës, loti I”.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë me një vlerë shpronësimi prej 175 375 941 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e një) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 865 000 (tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e shpronësimit prej 175 375 941 (njëqind e shtatëdhjetë e pesë milionë e treqind e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e një) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.

6. Shpronësimi të fillojë më 15.11.2010 dhe të përfundojë më 15.4.2011.

7. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Proces legalizimi”, do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë përfunduar procedurat e legalizimit dhe regjistrimit në ZRPP-në, Durrës dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kryejë likuidimin e pronarëve të pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Proces legalizimi”, në bazë të dokumentacionit ligjor të pronësisë, brenda afateve të përcaktuara në pikën 6 të këtij vendimi.

9. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës, ALUIZNI, qarku Durrës, të fillojë, brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rrugëve, procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do të vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Durrës dhe ALUIZNI, qarku Durrës, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**LISTA EMËRORE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS  
“Porto Romano-Durrës”, Loti i parë**

Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Zona Kadast.	Nr. pasurisë	Sip. Përgjith. m <sup>2</sup>	Lloji i pasurisë					Shuma lekë	Shënime
							Truall			Objekt			
							M <sup>2</sup>	Çmimi	Vlera lekë	Lloji	Vlera lekë		
1	Rifat	Rustem	Hoxha	8517	152/4	411	384	3600	1382400	Banesë 1-katëshe	4739903	6122303	Proces legalizimi
2	Qemal	Murat	Allamani	8517	152/2	487	223	3600	802800	Banesë 1-katëshe	2053652	2856452	Proces legalizimi
3	Baki	Fadil	Shenjitari	8517	152/93	386	122	3600	439200	Banesë 2-katëshe	5526174	5965374	Proces legalizimi
4	Skënder	Hasan	Pepa	8517	152/25	381	255	3600	918000	Banesë 1-katëshe	3761997	4679997	Proces legalizimi
5	Tofik	Zenel	Bershini	8517	152/81	329	271	3600	975600	Banesë 1-katëshe	3592437	4568037	Proces legalizimi
6	Enver	Zenel	Bershini	8517	152/78	183	180	3600	648000	Banesë 1-katëshe	2045952	2693952	Proces legalizimi
7	Rifat	Bajram	Dibra	8517	152/199	448	188	3600	676800	Banesë 1-katëshe	7671850	8348650	Proces legalizimi
8	Ahmet	Hasan	Pisli	8517	152/46	512	286	3600	1029600	Banesë 1-katëshe	3153007	4182607	Proces legalizimi
9	Dritan	Izet	Hysa	8517	152/219	400	400	3600	1440000	Banesë 1-katëshe	128008	1568008	Proces legalizimi
10	Xhevdet	Hajredin	Kutriqi	8517	152/45	517	512	3600	1843200	Banesë 1-katëshe	4333531	6176731	Proces legalizimi
11	Leonard	Xhevdet	Kutriqi	8517	152/44	295	184	3600	662400	Banesë 1-katëshe	257087	919487	Proces legalizimi
12	Nezir	Hasan	Pepa	8517	152/27	439	421	3600	1515600	Banesë 1-katëshe	4569924	6085524	Proces legalizimi
13	Flamur	Vehap	Uka	8517	152/220	218	218	3600	784800	Banesë 3-katëshe	10694736	11479536	Proces legalizimi
14	Zeqir	Selam	Parllaku	8517	152/239	318	318	3600	1144800	Banesë 1-katëshe	3520725	4665525	Proces legalizimi
15	Ahmet	Adem	Tufa	8517	152/243	294	294	3600	1058400	Banesë 1-katëshe	3833594	4891994	Proces legalizimi
16	Lavdrim	Rakip	Pisli	8517	152/62	210	210	3600	756000	Banesë 1-katëshe	440811	1196811	Proces legalizimi
17	Haxhi	Avdyl	Mulgeci	8517	152/198	304	304	3600	1094400	Banesë 1-katëshe	4126312	5220712	Proces legalizimi
18	Faik	Halil	Metra	8517	152/76	237	237	3600	853200	Banesë 1-katëshe	218091	1071291	Proces legalizimi
19	Hamide	Zenel	Kurmeta	8517	152/94	480	148	3600	532800	Banesë 1-katëshe	4842343	5375143	Proces legalizimi
20	Haxhi	Mehmet	Dunisha	8517	152/197	304	236	3600	849600	Banesë 1-katëshe	3970400	4820000	Proces legalizimi
21	Ukë	Rustem	Sula	8517	152/202	476	475	3600	1710000	Banesë 1-katëshe	3467360	5177360	Proces legalizimi
22	Oltjana	Sahit	Memaj	8517	152/296	397	91	3600	327600	Banesë 1-katëshe	5000784	5328384	Proces legalizimi
23	Ali	Zenel	Bershini	8517	152/83	430	250	3600	900000	Banesë 1-katëshe	2096467	2996467	Proces legalizimi
24	Ibrahim	Xhetan	Kalia	8517	152/96	286	282	3600	1015200	Banesë 1-katëshe	2267753	3282953	Proces legalizimi
25	Sulejman	Man	Topalli	8517	152/157	496	202	3600	727200	Banesë 1-katëshe	2881425	3608625	Proces legalizimi
26	Urim	Jaxha	Koliqi	8517	152/95	417	421	3600	1515600	Banesë 1-katëshe	4261741	5777341	Proces legalizimi
27	Veze	Myftar	Kalia	8517	152/97	314	106	3600	381600	Banesë 1-katëshe	3845478	4227078	Proces legalizimi
28	Shpëtim	Aqif	Aliaj	8517	152/21	301	142	3600	511200	Banesë 1-katëshe	239023	750223	Proces legalizimi
29	Riza	Rustem	Huna	8517	152/138	300	300	3600	1080000	Banesë 1-katëshe	3730765	4810765	Proces legalizimi
30	Selim	Zenel	Gjedia	8517	152/180	341	341	3600	1227600	Banesë 1-katëshe	4910831	6138431	Proces legalizimi
31	Ymer	Zenel	Gjedia	8517	152/179	275	275.5	3600	991800	Banesë 1-katëshe	3631344	4623144	Proces legalizimi
32	Isuf	Halil	Katraroshi	8517	152/178	198	189	3600	680400	Banesë 1-katëshe	3080292	3760692	Proces legalizimi
33	Qemal	Avdi	Kurti	8517	152/237	300	300	3600	1080000	Banesë 1-katëshe + 1	3919152	4999152	Proces legalizimi
34	Hajredin	Nazif	Miha	8517	152/134	517	515	3600	1854000	Banesë 1-katëshe	2757638	4611638	Proces legalizimi
35	Aranit	Rasim	Sokoli	8517	152/282	242	144	3600	518400	Banesë 1-katëshe	197627	716027	Proces legalizimi
36	Mark		Biba	8517	152/297	422	422	3600	1519200	Banesë 1-katëshe	2263324	3782524	Proces legalizimi

37	Petrit	Nazir	Kola	8517	152/113	431	6	3600	21600	Banesë 1-katëshe	2107327	2128927	Proces legalizimi
38	Hasime	Shpend	Shkreli	8517	152/175	299	211	3600	759600	Banesë 1-katëshe	1411947	2171547	Proces legalizimi
39	Fatos	Adem	Kadiu	8517	152/64	272	76	3600	273600	Banesë 1-katëshe	1821246	2094846	Proces legalizimi
40	Hamdi	Ramazan	Alliu	8517	152/260	423	259	3600	932400	Banesë 1-katëshe	2017142	2949542	Proces legalizimi
41	Fatmir	Minush	Dajçi	8517	152/181	166	10	3600	36000	Banesë 2-katëshe	5199531	5235531	Proces legalizimi
42	Shkëlzen		Mehaj	8517	152/253	224	39	3600	140400			140400	Proces legalizimi
43	Hysni		Shahini	8517	152/237	477	32	3600	115200			115200	Proces legalizimi
44	Hasan		Ceka	8517	152/118	320.8	320.8	3600	1154880	Banesë 1-katëshe	1906130	3061010	Proces legalizimi
	<b>Shuma</b>						<b>10800</b>		<b>38881080</b>		<b>136494861</b>	<b>175375941</b>	

**VENDIM**  
**Nr.863, datë 27.10.2010**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.66, DATË 3.2.2010 TË  
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RIORGANIZIMIN E DREJTORIVE ARSIMORE  
RAJONALE DHE ZYRAVE ARSIMORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 10 të ligjit nr.9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr.66, datë 3.2.2010 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në fjalinë e parë të pikës 4 pas fjalës “... funksionojnë ...” shtohen “... si rregull ...”.

b) Pika 6 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Për qarkun e Tiranës të ketë dy drejtori arsimore rajonale: DAR-ja, Tiranë, që do të mbulojë qytetin e Tiranës, dhe DAR-ja e qarkut të Tiranës, që do të mbulojë fshatrat e Tiranës, ZA-në, Kavajë dhe ZA-në, Kamëz, që do të mbulojë edhe komunat Paskuqan dhe Zall - Herr.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2010, i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës.

3. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.867, datë 5.11.2010**

**PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR DREJTORINË  
E SHËRBIMEVE QEVERTARE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor të Republikës së Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, t’i shtohet fondi prej 70 000 000 (shtatëdhjetë milionë) lekësh, për blerjen e një automjeti të blinduar, për parkun e delegacioneve.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.868, datë 27.10.2010**

**PËR SHPENZIMET DHE KOSTON EKONOMIKE PËR ZBATIMIN E PROCEDURAVE  
PËR MBLEDHJEN E DETYRIMEVE NGA SUBJEKTET DEBITORE QË KANË  
PËRFITUAR NGA FONDI KUNDËRPARTI DHE “NON PROJECT GRAND AID”, TË  
ARDHURA NGA GRANTET JAPONEZE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË E TË USHQIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Fondi gjendje, prej 17 000 000 (shtatëmbëdhjetë milionë) lekësh, i mbledhur nga arkëtimi i detyrimeve nga furnizimi me karburant pa akcizë, për mekanikën bujqësore, serrat me ngrohje dhe subjektet, që kanë kaldaja në linjat e përpunimit të qumështit, i vitit 2006, të përdoret për shpenzimet që nevojiten për mbledhjen e detyrimeve nga subjektet debitoare që kanë përfituar nga fondet kundërparti dhe “Non Project Grand Aid”, të ardhura nga grantet japoneze për sektorin e bujqësisë e të ushqimit.

2. Procedurat, efektet financiare dhe kostoja ekonomike për shpenzimet e çmontimit, për transportimin, magazinimin dhe ruajtjen e serrave me ngrohje e të linjave të përpunimit, të përcaktohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe të Ministrit të Financave.

3. Mënyra e administrimit dhe e shpenzimeve të këtij fondi për çmontimin, transportimin, magazinimin dhe ruajtjen bëhet sipas tarifave ligjore në fuqi.

4. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.873, datë 3.11.2010**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT E TË PËRFUNDIMIT TË REGJISTRIMIT TË  
PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE EKONOMIKE JOBUJQËSORE, SI DHE TË AFATIT TË  
PUBLIKIMIT TË TË DHËNAVE STATISTIKORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.10 202, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin e datës 8 nëntor 2010 për fillimin e regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore dhe të datës 6 dhjetor 2010 për përfundimin e këtij regjistrimi.

2. Caktimin e datës 15 dhjetor 2011, si afat për publikimin e të dhënave statistikore.

3. Ngarkohet Instituti i Statistikave (INSTAT) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.874, datë 3.11.2010**

**PËR TRAJNIMIN E PERSONELIT TË REGJISTRIMIT TË PËRGJITHSHËM TË NJËSIVE  
EKONOMIKE JOBUIJQËSORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 16 të ligjit nr.10 202, datë 17.12.2009 “Për regjistrimin e përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore”, me propozimin e Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. I gjithë personeli i regjistrimit të përgjithshëm të njësive ekonomike jobujqësore duhet t'i nënshtrohet trajnimit, sipas programit përkatës, të hartuar nga Instituti i Statistikave (INSTAT).

2. Programi i trajnimit të përbëhet nga pjesa e përgjithshme (A) dhe pjesa e veçantë (B).

2.1 Në pjesën e përgjithshme (A) është materiali i trajnimit për të gjithë personelin, që do të merret me regjistrimin, ku duhet të përfshihen njohuritë për:

a) qëllimin e regjistrimit, objektivin, përkufizimet dhe konceptet, bazën ligjore, mbrojtjen e të dhënave personale;

b) komponentët e pyetësorit, manualet e përdorimit, klasifikimet, teknologjinë e informacionit që do të përdoret, si dhe sistemet e hartografisë.

2.2 Në pjesën e veçantë (B) është materiali i trajnimit për kategorinë specifike të personelit, që do të merret me regjistrimin dhe konkretisht:

a) Për mbikëqyrësit, materiali i trajnimit duhet të përfshijë mënyrën e organizimit të punës në terren, çështjet e logjistikës dhe mënyrat e shpërndarjes e të grumbullimit të pyetësorëve, si dhe mënyrat e organizimit e të monitorimit të punës së kontrollorëve.

b) Për kontrollorët, materiali i trajnimit duhet të përmbajë mënyrën e punës në terren, çështjet e logjistikës dhe metodat e shpërndarjes e të grumbullimit të të dhënave, metodat e monitorimit e të kontrollit të cilësisë së punës së anketuesve.

c) Për anketuesit, veç pjesës së përgjithshme, trajnimi do të fokusohet edhe në njohjen me përmbajtjen e pyetësorit, mënyrat e plotësimit të tij gjatë intervistimit, përdorimin e pajisjeve GPS (Global Positioning System) në terren, si dhe mënyrat e raportimit e detyrat ndaj kontrollorit.

3. Trajnimi i stafit mbikëqyrës të kryhet me një grup për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) ditë.

4. Trajnimi i stafit kontrollor të kryhet me dy grupe për një periudhë jo më shumë se 5 (pesë) ditë për secilin grup.

5. Trajnimi i stafit anketues të kryhet me 30 grupe për një periudhë jo më shumë se 4 (katër) ditë.

6. Trajnimi i personelit të regjistrimit të përfundojë jo më vonë se 7 (shtatë) ditë para fillimit të intervistimit në terren.

7. Ngarkohet INSTAT-i për zbatimin e këtij vendimi dhe për caktimin e trajnerëve përkatës për çdo grup.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.877, datë 3.11.2010**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN SI REZULTAT I REALIZIMIT TË REZERVUARIT GRUMBULLUES TË UJËRAVE TË SHIUT, KORÇË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik” dhe të nenit 8, të ligjit nr.9836, datë 26.11.2007 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2008”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i realizimit të rezervuarit grumbullues të ujërave të shiut, Korçë
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Korçë.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen e përgjithshme 3500 (tremijë e pesëqind) m<sup>2</sup>, tokë truall, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 65 579 500 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekësh.
4. Shpenzimet procedurale, në shumën 343 500 (treqind e dyzet e tre mijë e pesëqind) lekë të përballohen nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë.
5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 65 579 500 (gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind) lekësh, të përballohet nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”.
6. Shpronësimi të fillojë më 1.11.2010 dhe të përfundojë më 1.2.2011.
7. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, të bëjë likuidimin e pronarëve brenda afatit të parashikuar në pikën 6 të këtij vendimi
8. Pronarët e përmendur në listën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja, Korçë (bashkëpronësi)”, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Ujësjellës-Kanalizimeve sh.a., Korçë.
9. Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, të kryejë likuidimin e pronarëve, për të cilët është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZRPP-ja, Korçë, (bashkëpronësi)”, pasi ata të kenë dorëzuar dokumentacionin e plotë të pronësisë.
10. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, të fillojë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’i vihet në dispozicion nga Ujësjellës-Kanalizime sh.a., Korçë, si dhe të bëjë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.
11. Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.
12. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**



Tabela

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Nr.i zonës kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip. truall m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Vlera totale lekë	Shënime
1	Petraq Pendavinji	8561	11/36	913	18.737	17.106.881	17.106.881	Konfirmuar nga ZRPP-ja
2	Teneqexhi e Xharo	8561	11/68	2587	18.737	48.472.619	48.472.619	Konfirmuar nga ZRPP-ja
						<b>Totali</b>	<b>65 579 500</b>	

Adresa: “Vasil Tromara”, lagjja 12, nr.15, Korçë.

Pasuria me nr.11/68 është në pronësi të 18 bashkëpronarëve si më poshtë:

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Adresa
1	Katerina Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.16 Korçë
2	Natasha Sotir Teneqexhi	Rr. “28 Nëntori” lagjja 16, Pall.3 Korçë
3	Petraq Sotir Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.16 Korçë
4	Rozeta Sotir Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.16 Korçë
5	Elisaveta Sotir Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.14 Korçë
6	Anesti Kiço Teneqexhi	Shëtitorja “Fan Noli” lagjja.5, pall.nr.26, shk.A/5 Korçë
7	Ilija Kiço Teneqexhi	Shëtitorja “Fan Noli” lagjja.5, pall.nr.26, shk.A/5 Korçë
8	Keti Kiço Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.14 Korçë
9	Romeo Kiço Teneqexhi	Rr. “Ali Visha” Ap.18, shk.2 Korçë
10	Kostanca Petro Xharo	Rr. “Ptolemeu Xhuvani” lagjja 1, Korçë
11	Thoma Petro Xharo	Rr. “Alqi Kondi” lagjja 3, nr.1 Korçë
12	Robert Petro Xharo	Rr. “Alqi Kondi” lagjja 3, nr.1 Korçë
13	Dhimitraq Koço Teneqexhi	Rr. “Pano Xhamballo” lagjja 10, pall 16 H/c-2 Korçë
14	Pandeli Koço Teneqexhi	Rr. “Pano Xhamballo” lagjja 10, pall 16 H/c-2 Korçë
15	Irimi Koço Teneqexhi	Rr. “Pano Xhamballo” lagjja 10, pall 16 H/c-2 Korçë
16	Ipathia Ili Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.6 Korçë
17	Kozeta Gaqo Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.6 Korçë
18	Dhori Gaqo Teneqexhi	Rr. “Koço Stralla” lagjja 11, nr.6 Korçë

## VENDIM

**Nr.879, datë 3.11.2010**

### **PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.138, DATË 14.3.2007 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PROCEDURËN E TRAJTIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË HEQURA NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 7 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

#### VENDOSI:

1. Në fund të pikës 1 kreut II të vendimit nr.138, datë 14.3.2007 të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përfshihen nga çmilitarizimi të gjitha llojet e kapsollave, fitilave plasës, ndezësit dhe zjarrpërcjellësit, dinamitet dhe amonitet.”.

2. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.880, datë 3.11.2010**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR PËR MINISTRINË  
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT NË GREQI, TË  
FËMIJËS MOREL PASHALLARI**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 44 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2010, zëri “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 1 100 000 (një milion e njëqind mijë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit, në Greqi, të fëmijës Morel Pashallari.
  2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit.
  3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit shëndetësor të kurimit.
  4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.881, datë 3.11.2010**

**PËR CAKTIMIN E ZONAVE TË VENDOSJES SË ANTENAVE TË KOMUNIKIMIT DHE  
TË ATYRE RADIO-TELEVIZIVE NË PARKUN KOMBËTAR “MALI I DAJTIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 33 të ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 “Për zonat e mbrojtura”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Caktimin e vendeve për vendosjen e antenave të komunikimit dhe të atyre radio-televizive në territorin e parkut kombëtar “Mali i Dajtit”, në zonat si më poshtë vijon:
  - a) Blloku “1”, në majën e malit të Tujanit (1531 m), me sipërfaqe 300 (treqind) m<sup>2</sup> dhe me koordinata 44 09 279L dhe 45 83 149V.
  - b) Blloku “2”, në majën e malit të Dajtit (1613 m), me sipërfaqe 1200 (një mijë e dyqind) m<sup>2</sup> dhe me koordinata 44 10 033L dhe 45 82 079V.
  - c) Blloku “3”, në majën e malit të Derjes (1308 m), me sipërfaqe 600 (gjashtëqind) m<sup>2</sup> dhe me koordinata 44 17 538L dhe 45 79 068V.
  - ç) Blloku “4”, pranë qendrës së vizitorëve të parkut kombëtar, në kryqëzimin e rrugës që të çon te rezidencat qeveritare dhe në sheshin kryesor të parkut, me sipërfaqe 4960 (katër mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë) m<sup>2</sup> dhe me këto koordinata:
    - Pika 1, 44 09 048L dhe 45 81 218V;
    - Pika 2, 44 09 024L dhe 45 81 216V;
    - Pika 3, 44 09 055L dhe 45 81 177V;
    - Pika 4, 44 09 109L dhe 45 81 149V;

Pika 5, 44 09 135L dhe 45 81 149V;  
Pika 6, 44 09 160L dhe 45 81 119V;  
Pika 7, 44 09 180L dhe 45 81 168V;  
Pika 8, 44 09 111L dhe 45 81 187V;  
Pika 9, 44 09 081L dhe 45 81 193V.

d) Blloku "5", pranë qendrës së vizitorëve të parkut kombëtar, në kryqëzimin e rrugës që të çon te rezidencat qeveritare, me sipërfaqe 640 (gjashtëqind e dyzet) m<sup>2</sup> dhe me këto koordinata:

Pika 1, 44 09 336L dhe 45 81 277V;  
Pika 2, 44 09 325L dhe 45 81 288V;  
Pika 3, 44 09 342L dhe 45 81 303V;  
Pika 4, 44 09 361L dhe 45 81 282V;  
Pika 5, 44 09 348L dhe 45 81 267V.

dh) Blloku "6", pranë qendrës së vizitorëve të parkut kombëtar, në kryqëzimin e rrugës që të çon te rezidencat qeveritare, me sipërfaqe 560 (pesëqind e gjashtëdhjetë) m<sup>2</sup> dhe me këto koordinata:

Pika 1, 44 09 207L dhe 45 81 368V;  
Pika 2, 44 09 208L dhe 45 81 386V;  
Pika 3, 44 09 226L dhe 45 81 383V;  
Pika 4, 44 09 226L dhe 45 81 370V;  
Pika 5, 44 09 215L dhe 45 81 353V.

e) Blloku "7", sipër depos së ujit, me sipërfaqe 100 (njëqind) m<sup>2</sup> dhe me koordinata 44 09 514L dhe 45 80 350V.

2. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nëpërmjet strukturave të saj të varësisë, evidenton sipërfaqet që përdoren aktualisht nga operatorët e komunikimit dhe ata radio-televizivë, si dhe shlyerjen detyrimeve kontraktore. Për operatorët që kanë nënshkruar kontrata me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Tiranë, zbatimi i tyre do të vijojë deri në përfundimin e afateve të nënshkruara. Rinovimi i kontratave të kryhet vetëm pas vlerësimit të zbatimit të ligjshmërisë dhe hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, nëpërmjet strukturave të saj të varësisë, për të gjitha subjektet që disponojnë antena të komunikimit dhe ato radio-televizive, por që nuk kanë leje ndërtimore, të miratuar nga KRRTRSH-ja e në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, pezullon kontratat dhe kryerjen e veprimtarisë, deri në vlerësimin dhe plotësimin e detyrimeve ligjore, brenda një afati kohor 1-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

4. Në blloqet e caktuara për vendosjen e antenave të komunikimit dhe atyre radio-televizive, në territorin e parkut kombëtar "Mali i Dajtit", pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, marrëdhëniet për shërbimet dhe nënshkrimi i kontratave për sipërfaqet e dhëna në përdorim për secilin operator, kryhen vetëm me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor, Tiranë, në përputhje me dispozitat e ligjit nr.8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura", të ndryshuar, dhe të Kodit Civil.

5. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.882, datë 5.11.2010**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2010, MIRATUAR, PËRKATËSISHT,  
PËR MINISTRINË E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGETIKËS DHE MINISTRINË  
E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE, PËR PAGESËN E DETYRIMEVE  
NDAJ KOMISIONIT EUROPIAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2010 të shtohet fondi prej 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekësh, për shlyerjen e detyrimit ndaj Komisionit Europian, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës 77 700 000 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e shtatëqind mijë) lekësh;

b) Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve 4 300 000 (katër milionë e treqind mijë) lekësh.

2. Fondi prej 82 000 000 (tetëdhjetë e dy milionë) lekësh të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**VENDIM**  
**Nr.883, datë 9.11.2010**

**PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.591, DATË 23.7.2010 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR DISIPLINIMIN E PËRDORIMIT TË FONDEVE BUXHETORE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9643, datë 21.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të ligjit nr.10 190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në fund të shkronjës “dh” të pikës 1 të vendimit nr.591, datë 23.7.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Përrjashtimisht, lejohet Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare, si autoritet kontraktor, të vijojë kryerjen e procedurave të prokurimit, për blerjen e një automjeti të blinduar, për parkun e delegacioneve.”.

2. Ngarkohen Kryeministria, Ministria e Financave dhe Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**UDHËZIM**  
**Nr.6, datë 21.10.2010**

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.10289, DATË 17.6.2010 “PËR MËNYRËN E TRAJTIMIT EKONOMIK E FINANCIAR DHE PËR DHËNIE NDIHME TË MENJËHERSHME FAMILJEVE TË PUNONJËSVE TË POLICISË SË SHTETIT, TË GARDËS SË REPUBLIKËS, TË SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË BRENDSHËM, TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE TË SHPËTIMIT, TË FORCAVE TË ARMATOSURA, TË SHËRBIMIT INFORMATIV TË SHTETIT DHE TË POLICISË SË BURGJEVE, QË HUMBIN JETËN NË KRYE APO PËR SHKAK TË DETYRËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr.10289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës” dhe të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

**UDHËZON:**

1. Në zbatim të nenit 1 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, në vijim i referuar si ligji, konsiderohen “Humbje e jetës në krye apo për shkak të detyrës”, rastet që ndodhin:

a) gjatë kohës së kryerjes së detyrës apo shërbimit, kur ngjarja ka ndodhur për arsye që lidhen me detyrën;

b) jashtë kohës së kryerjes së detyrës, kur shkak për ndodhjen e ngjarjes janë veprimet e ligjshme të punonjësit në kryerjen e detyrës.

Rrethanat e mësipërme duhet të vërtetohen nga organet e drejtësisë, prokurori, gjykata, sipas juridiksionit të tyre.

2. Përfitimet, që jepen sipas nenit 2 të ligjit, garantohen nga Buxheti i Shtetit. Llogaritja, caktimi dhe pagimi i përfitimeve bëhen nga strukturat e Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

3. Në çdo rast, kur punonjësi humbet jetën në krye apo për shkak të detyrës, anëtarëve të familjes së caktuar në nenin 3 të ligjit, u jepet një ndihmë e menjëhershme financiare, jo më pak se 200 000 (dyqind mijë) lekë për çdo person, pasi nga subjektet përfituese të paraqitet dokumentacioni i mëposhtëm:

a) Procesverbali i referimit nga strukturat përkatëse të rrjedhës së ngjarjes, gjatë së cilës humbi jetën punonjësi;

b) vendimi apo vërtetimi, ku organi i drejtësisë të shprehet për shkakun e humbjes së jetës;

c) certifikatë e gjendjes familjare në datën e ndodhjes së ngjarjes;

ç) certifikatë vdekjeje e punonjësit;

d) dokumenti i identitetit të personit që kërkon përfitimin.

Masa e ndihmës së menjëhershme financiare dhe subjektet që e përfitojnë atë, miratohen me urdhër të titullarit të institucionit qendror dhe përballohen nga buxheti i miratuar për njësinë shpenzuese përkatëse.

4. Në zbatim të nenit 4 të ligjit, organizimi i ceremonisë dhe shpenzimet e varrimit për punonjësit, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, miratohen nga titullari i institucionit qendror dhe përballohen nga buxheti i miratuar për njësinë shpenzuese përkatëse, sipas dokumenteve që justifikojnë shpenzimet.

5. Në zbatim të nenit 5 të ligjit, për çdo vit akademik strukturat e përmendura në nenin 1 të ligjit, i paraqesin Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, listën e fëmijëve që kanë fituar të drejtën e ndjekjes së studimeve të larta, për trajtimin e tyre me bursë.

6. Në zbatim të nenit 6 të ligjit, trajtimi me strehim i familjeve të punonjësve, që kanë humbur jetën në krye apo për shkak të detyrës, bëhet sipas kriterëve, dokumentacionit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 “Për programet sociale për strehimin e banorëve të zonave urbane”, të ndryshuar, duke realizuar trajtimin me përparësi të këtyre familjeve, krahasuar me subjektet e tjera përfituese sipas ligjit.

7. Në zbatim të nenit 7 të ligjit, masa e ndihmës me rastin e ditës përkujtimore të punonjësit, miratohet me urdhër të titullarit të institucionit qendror dhe përballohet nga buxheti i miratuar për njësinë shpenzuese përkatëse.

8. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Drejtësisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

**Njoftojmë se kanë filluar abonimet për vitin 2011 për Fletoren Zyrtare.**

**Afati i abonimit mbaron më 31.1.2011.**

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.**

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

### BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 22.11.2010

Doli nga shtypi më 24.11.2010

Tirazhi: 2300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT

Tiranë, 2010

Çmimi 40 lekë